



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*

**ANALIZË E RISHIKIMIT STRATEGJIK TË SEKTORT TË SIGURISË  
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Prishtinë, Mars 2014

## PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive e RSSS-së.....	4
<b>Kapitulli 1. Hyrje .....</b>	<b>6</b>
<b>Seksioni 1.1. Qëllimi i RSSS.....</b>	<b>6</b>
<b>Seksioni 1.2. Sfondi .....</b>	<b>8</b>
<b>Kapitulli 2. Procesi i RSSS .....</b>	<b>11</b>
<b>Seksioni 2.1. Objektivat e RSSS.....</b>	<b>11</b>
<b>Seksioni 2.2. Kushtet e Punës (Termet e Referencës) dhe fazat e RSSS.....</b>	<b>12</b>
<b>Kapitulli 3. Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Kosovës.....</b>	<b>14</b>
<b>Seksioni 3.1 Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare .....</b>	<b>14</b>
<b>Kapitulli 4. Mjedisi Strategjik i Sigurisë të Republikës së Kosovës.....</b>	<b>15</b>
<b>Seksioni 4.1. Konteksti strategjik .....</b>	<b>15</b>
<b>Seksioni 4.2. Mjedisi Global i Sigurisë .....</b>	<b>15</b>
<b>Seksioni 4.4. Mjedisi i brendshëm i sigurisë .....</b>	<b>17</b>
<b>Seksioni 4.5. Kërcënimet jo-konvencionale .....</b>	<b>19</b>
<b>Kapitulli 5. Politikat e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Republikës së Kosovës .....</b>	<b>20</b>
<b>Seksioni 5.1. Koncepti i Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes .....</b>	<b>20</b>
<b>Seksioni 5.2. Politikat e brendshme për Sigurinë e Republikës së Kosovës .....</b>	<b>20</b>
<b>Seksioni 5.3. Politikat rajonale për siguri të Republikës së Kosovës .....</b>	<b>21</b>
<b>Seksioni 5.4. Politikat Globale për Siguri të Republikës së Kosovës.....</b>	<b>22</b>
<b>Kapitulli 6. Arkitektura e ardhshme e sektorit të sigurisë të Republikës së Kosovës .....</b>	<b>22</b>
<b>Kapitulli 7. Analiza e Ministrive të sektorit të Sigurisë .....</b>	<b>23</b>
<b>Seksioni 7.1. Ministrinë e Analizuara nga RSSS.....</b>	<b>23</b>

<b>7.1.3. Ministria e Forcës së Sigurisë (MFSK)</b> .....	30
<b>Kapitulli 8 – Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të RSS-së</b> .....	59
<b>Aneksi A - Shkurtesat</b> .....	63

## **Përmbledhje Ekzekutive e RSSS-së**

Republika e Kosovës, si shtet sovran, e merr seriozisht përgjegjësinë e ofrimit të sigurisë për qytetarët dhe territorin të saj. Republika e Kosovës është mirënjohëse ndaj institucioneve ndërkombëtare për rolin e rëndësishëm që ato kanë luajtur në zhvillimin e sektorit të sigurisë së Kosovës dhe më gjerë, për mbajtjen e mjedisit të sigurt në Kosovë. Në të njëjtën kohë, Kosova e njeh rëndësinë e vazhdimit të ngritjes së aftësisë për institucionet e veta për të ofruar siguri të gjithë qytetarëve të Kosovës. Prandaj, si pjesë e procesit të marrjes graduale të më shumë përgjegjësi për sigurinë e saj, në Mars të vitit 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka iniciuar Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), një rishikim gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve të saja të sigurisë. Qëllimi i RSSS-së është të bëhet një analizë e hollësishme të të gjitha aspekteve të sigurisë në Republikën e Kosovës për ti analizuar sfidat e sigurisë e së tashmes dhe së ardhmes; të përcaktohen qartë rolet e secilit institucion në sektorin e sigurisë për t'ju shmangur dyfishimit dhe për t'i maksimalizuar kapacitetet institucionale; si dhe të identifikohen kapacitetet e nevojshme për të ofruar mbrojtje dhe siguri qytetarëve të Kosovës. Përmes kësaj analize, RSSS-ja i ka prodhuar udhëzime të politikave të nivelit strategjik dhe rekomandimet konkrete për sektorin e sigurisë së Kosovës. Rezultatet e rishikimit janë të përfshira në raportin pasues.

Vizioni i Republikës së Kosovës është të jetë shtet që promovon stabilitet dhe siguri, jo vetëm për popullatën e saj por edhe për rajonin dhe Evropën më të gjerë. Republika e Kosovës aspiron të jetë pjesë përbërëse e strukturave të sigurisë rajonale dhe globale, e në veçanti e BE-së, NATO-së, OSBE-ës dhe OKB-së. Ajo gjithashtu dëshiron që të mirëmban dhe promovon marrëdhëniet paqësore fqinjësore për ta ngritur stabilitetin dhe besimin në mes të vendeve të rajonit. Populli dhe Qeveria e Republikës së Kosovës janë të vendosur të jetojnë në vend me prosperitet, vend paqësor dhe shumetnik i cili garanton liri dhe mirëqenie të të gjithë qytetarëve të saj ashtu siç është edhe e cekur në Kushtetutë. Republika e Kosovës ndjek rrugën e anëtarësimit dhe integritit në strukturat Euro-Atlantike të cilat mbesin emërtuesi më i fuqishëm për Kosovën, si dhe një tregues i gatishmërisë dhe e konfirmojnë dëshirën e vendit për tu bërë eksportues i sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Në të vërtetë, siguria kombëtare e Kosovës është e lidhur ngushtë me sigurinë rajonale dhe sigurinë më të gjerë Euro-Atlantike.

Procesi i RSSS-së ka pasur qasje gjithëpërfshirëse, dhe i kapërfshirë të gjitha institucionet e sektorit të sigurisë si: Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK), policinë dhe shërbimet e inteligjencës sikur edhe ministritë përgjegjëse si atë të: FSK-së, punëve të jashtme, të punëve të brendshme, të drejtësisë, financave, shëndetësisë, edukimit, mjedisit dhe infrastrukturës. Procesi e ka përshirë një grup punues të themeluar, e të përbërë nga akterët e sektorit të sigurisë i njohur si Grupi Punues Ndërministror i RSSS-së. Si rishikim i parë pas shpalljes së Pavarësisë në Kosovë, RSSS-ja e ka vë theks në kontekstin vendor duke nxit udhëheqësin dhe pronësinë vendore me synim përfundimtar që institucionet e sektorit të sigurisë të bëhen më efikase, efektive dhe të përgjegjshme ndaj qytetarëve të Kosovës.

Në raportin në vazhdim, secili institucion të sektorit të sigurisë të përfshirë në RSSS e përshkruan bazat e tij ligjore, rolet dhe misionet e tanishme, si do të ndryshojnë rolet dhe misionet e tyre dhe ofron rekomandime të cilat paraqesin konsolidimin e vazhdueshëm të institucioneve të sigurisë në Kosovë. Duke pasur parasysh qasjen e koordinuar mirë ndaj implementimit të RSSS-së, Zyra e Kryeministrit do të luaj rol qendror në vendosjen e prioriteteve dhe mbikëqyrjen e implementimit të rekomandimeve të RSSS-së dhe sigurimin që procesi i implementimit të mbetet i përballeshëm dhe transparent.

Përmes analizës së hollësishme dhe metodike , të bërë gjatë periudhës dy vjeçare , RSSS-ja ka nxjerr në pah nevojën për zhvillimin gradual të kapaciteteve për të marr përgjegjësitë më të mëdha në përputhje me obligimin e Republikës së Kosovës në ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të saj territorial. RSSS rekomandon zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme dhe shuarjen e atyre të panevojshme; si dhe ofron rekomandimet për ndryshimet e nevojshme legislative si rezultat i të gjeturave të RSSS-së. RSSS-ja e ka identifikuar nevojën që të rishikohet Strategjia e Sigurisë Kombëtare; të hartohet Strategjia e Mbrojtjes Kombëtare dhe të rishikohet dhe ripërpunohet Plani i Reagimit Kombëtar për ti pasqyruar të gjeturat e RSSS-së. RSSS-ja rekomandon tranzicionin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës me mision të ruajtjes së integritetit territorial të vendit, ofrimit të mbështetjes ushtarake e autoriteteve civile në raste fatkeqësie dhe pjesëmarrjen në operacione paqeruajtëse; si dhe tranzicionin e Ministrisë së FSK-së në Ministrinë e Mbrojtjes me përgjegjësi të ofrimit të mbikëqyrjes civile dhe udhëzimeve për Forcat e reja të Armatosura të Kosovës. Gjithashtu, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) do të punoj ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes (MM) për të transferuar përgjegjësitë me kalimin

e kohës tek MPB në fushën e menaxhimit të emergjencave. Duke pasur parasysh aspiratat Euro-Atlantike të Kosovës dhe anëtarësimin në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) do të vazhdoj ta rrisë praninë e saj jashtë Republikës së Kosovës, si shtyllë kryesore diplomatike e sigurisë në vend. Për shkak të nevojës së Programit mësimor në fushën e sigurisë për të shkolluar dhe trajnuar studentët universitar me qëllim që të asistojnë në zhvillimin e udhëheqësve të ardhshëm në sektorin e sigurisë, RSSH-ja rekomandon që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të punoj për ta zhvilluar Programin mësimor të Mbrojtjes dhe Sigurisë në Universitetin e Prishtinës. Republika e Kosovës ka perspektivë Euro-Atlantike dhe ka për qëllim që ta përmirësoj raportet e saja me institucionet Euro-Atlantike. Prandaj RSSH-ja gjithashtu rekomandon që Zyra e Kryeministrit të formoj Grup Punues ndërministror të NATO-së për të ndihmuar në lehtësimin e thellimit të raporteve me Aleancën. Shkurt, qëllimi parësor i Raportit të RSSH-së është që t'i ofroj Qeverisë së Kosovës një pako të rekomandimeve për zhvillimin transparent, të balancuar dhe të përbalueshëm të institucioneve të sigurisë së Kosovës për tu ballafaquar me sfidat e sigurisë e së tashmes dhe së ardhmes.

## **Kapitulli 1. Hyrje**

### **Seksioni 1.1. Qëllimi i RSSH**

Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë (RSSH) është një proces i iniciuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në mars të vitit 2012. Republika e Kosovës, që nga shpallja e pavarësisë më 17 shkurt 2008, është njohur nga më shumë se njëqind shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe është bërë një aktor shtetëror me përgjegjësi për sigurinë kombëtare dhe rajonale. Republika e Kosovës është përgjegjëse për të garantuar sigurinë e qytetarëve të saj dhe për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të saj. Si rezultat, Republika e Kosovës është duke ndërmarr hapa për të ushtruar sovranitetin e saj në një mënyrë të përgjegjshme bazuar në vlerat themelore të lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe sundimit të ligjit. Prandaj, si një anëtare e re në familjen e kombeve, Republika e Kosovës është e vetëdijshme për përgjegjësitë e saja në fushën e sigurisë dhe se përmbushja e përgjegjësisë së tillë kërkon një qasje të gjerë, strategjike dhe gjithëpërfshirëse të Qeverisë.

Natyrisht, kjo nënkupton që Qeveria e Republikës së Kosovës gjithashtu të ketë parasysh perspektivën globale, rajonale dhe lokale të sigurisë shtetërore. Zhvillimet përtej Republikës së Kosovës mund të kenë ndikim në sigurinë kombëtare të vendit. Si rrjedhojë, është evidente se siguria shtetërore është ngushtë e lidhur dhe varur në sigurinë e rajonit dhe mbarë Evropës. Paqja dhe stabiliteti në Evropë dhe më tej, varet në bashkëpunimin ndërmjet shteteve, qoftë në baza njëpaleshe apo shumëpaleshe ose në kuadër të organizatave ndër-qeveritare. Bashkëpunimi rajonal në sektorin e sigurisë është i domosdoshëm jo vetëm për luftimin e kërcënimeve e përbashkëta, por gjithashtu për tejkalimin asaj që është trashëguar nga kaluara dhe minimizimin e tensioneve dhe kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Prandaj, është fakt i qenë se Republika e Kosovës mund të jetë e sigurt nëse rajoni dhe Evropa janë të sigurt. Për të përmbyllur, Republika e Kosovës duhet të shikoj drejt së ardhmes, kur sfidat ndaj sigurisë të të gjitha niveleve do të jenë përgjegjësi e Qeverisë për tu adresuar. Si rezultat, tani është koha e përshtatshme për të vendosur themelet për aftësinë e Qeverisë së Kosovës për të mbrojtur Shtetin në të gjitha nivelet në një mënyrë reale, të përballueshme financiarisht dhe gjithëpërfshirëse.

Vizioni i Republikës së Kosovës është që të bëhet një forcë e stabilitetit dhe sigurisë, jo vetëm për popullatën e saj, por edhe për rajonin dhe mbarë Evropën. Republika e Kosovës aspiron të bëhet pjesë përbërëse e strukturave rajonale dhe globale të sigurisë, në veçanti e NATO-së, BE-së, OSBE-së dhe OKB-së. Gjithashtu aspiron të mbajë marrëdhënie paqësore me fqinjët e saj, ku dhe së fundi, në prill të vitit 2013 ka arritur një marrëveshje normalizimi me Republikën e Serbisë, që do të shtoj stabilitetin dhe besimin ndërmjet kombeve në rajon dhe promovoj raporte të mira fqinjësore. Qytetarët dhe Qeveria e Republikës së Kosovës janë të përkushtuar për të jetuar në një shtet paqësor, prosperues dhe shumetnik që garanton liritë dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve sikurse është mishëruar me Kushtetutë.

Në pikëpamje të rrethanave të lartpërmendura (nevoja për ofruar siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe nevoja për të përcaktuar drejtimin strategjik për sektorin e sigurisë së Kosovës) më 21 mars 2012, Republika e Kosovës mori vendimin që për herë të parë si vend i pavarur të ndërmarr Rishikimin Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS). Qëllimi i procesit të RSSS-së është ndërmarrja e një analize gjithëpërfshirëse të tërë qeverisë, të të gjitha aspekteve të sigurisë në Republikën e Kosovës në mënyrë që të identifikoj nevojat e sigurisë të vendit dhe qytetarëve të saj. Për më tepër, ky proces synon të identifikoj qartësisht rolet e secilit institucion në sektorin

e sigurisë, në mënyrë që të mënjanoj dyfishimet dhe të shtoj kapacitetet institucionale - njerëzore ashtu edhe financiare - për përmbushjen e nevojave të sigurisë në mënyrë efektive dhe efikase. Përmes kësaj analize, RSSS ka prodhuar drejtime të nivelit strategjik dhe rekomandime konkrete për sektorin e sigurisë së Kosovës.

## **Seksioni 1.2. Sfondi**

### **1.2.1. Sfondi politik**

Republika e Kosovës shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe theksoi përkushtimin dhe konfirmimin se shpallja e pavarësisë ishte në përputhje me të Dërguarin e Posaçëm të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari dhe Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe se Republika e Kosovës pranoi dhe miratoi plotësisht obligimet që dilnin nga Planit i Ahtisaar-it duke mirëpritur kornizën që propozonte për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Parimet e plota të Planit Ahtisaari ishin përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës që hyri në fuqi në qershor të vitit 2008.

Në pajtim me Planin Ahtisaari, ishte vendosur Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar për Kosovën (PCN), i cili kishte edhe rolin e Përfaqësuesit të Posaçëm të Bashkimit Evropian (PPBE), i raportonte dhe funksiononte nën mbikëqyrjen e Grupit Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën (GDN) – një grup i vendeve që e kishin njohur dhe përkrahur pavarësinë e Kosovës, i përbërë prej 23 vende anëtare të Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara dhe Turqia. GDN ofronte përkrahje për Zyrën Civile Ndërkombëtare (ZCN) që ishte vendosur në Prishtinë për të drejtuar zhvillimin demokratik të Kosovës, qeverisjen e mirë, shumetnicitetin dhe sundimin e ligjit; dhe të mbikëqyr Qeverinë e Kosovës në zbatimin e Planit Ahtisaari. Pas zbatimit të suksesshëm të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës, si rezultat i rekomandimeve nga ZCN, Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën (GDN) më 10 shtator 2012 në mënyrë formale përfundoi mbikëqyrjen e pavarësisë së Kosovës dhe Qeveria e Kosovës tanimë ishte bërë përgjegjëse për qeverisjen e saj.

Republika e Kosovës ka zhvilluar një partneritet të suksesshëm me praninë ndërkombëtare në Kosovë, si NATO/KFOR, Misionin e Bashkimit Evropian në fushën e sundimit të ligjit (EULEX), dhe instrumente të tjera të njohura nga Republika e Kosovës. Republika e Kosovës



është mirënjohëse për rolin e rëndësishëm të institucioneve ndërkombëtare në zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve të sektorit të sigurisë dhe sundimit të ligjit të Kosovës, dhe në përgjithësi në krijimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. Duke qenë se prania e këtyre institucioneve do të zvogëlohet, është me rëndësi për Kosovën të vazhdoj të konsolidoj dhe fuqizoj sektorin e saj të sigurisë.

### **1.2.2. Qasja e gjithëpërfshirëse e qeverisë për RSSS-në**

Një nga tiparet më të rëndësishme, gjatë realizimit të rishikimit të sektorit të sigurisë në tërë qeverinë ka qenë marrja parasysh e kontekstit vendor, duke i dhënë RSSS-së si proces pronësi të plotë vendore. RSSS ishte iniciuar për të bërë përpjekje për një bashkëpunim të fuqizuar ndërqeveritar dhe ndërinstitucional ndërmjet akterëve të sektorit të sigurisë, si FSK-ja, shërbimi policor dhe i inteligjencës, por gjithashtu edhe ministritë e FSK-së, punëve të jashtme, punëve të brendshme, drejtësisë, financave, shëndetësisë, edukimit, mjedisit dhe infrastrukturës në mënyrë që të përballohen dhe kundërshtohen kërcënimet si krimi i organizuar, terrorizmi, dhe ndonjë kërcënim tjetër që i paraqitet Republikës së Kosovës nga brenda ose jashtë territorit të saj. Në këtë mënyrë, RSSS përfaqëson një konsolidim gjithëpërfshirës dhe largpamës të institucioneve të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës është duke kryer RSSS-në për qëllime të veta, duke i bërë institucionet e saja më efikase, efektive, transparente dhe të përgjegjshme e llogaridhënëse ndaj qytetarëve të Kosovës. Këto përpjekje t; Qeverisë së Kosovës kanë për qëllim ndryshimin e imazhit të brendshëm dhe të jashtëm të saj; për të demonstruar se nuk është një vend i njohur thjesht si konsumues i sigurisë dhe ngarkesë mbi komunitetin ndërkombëtar, por mund të jetë një kontribuues i sigurisë dhe një partner i vetë-qëndrueshëm dhe i besueshëm për të ofruar dhe dhënë ekspertizën e saj në zona të ndryshme të katastrofave humanitare dhe misione paqeruajtëse nën mandatin e OKB-së, BE-së, OSBE-së dhe NATO-së.

### **1.2.3. Parashikimet Ekonomike**

Procesi i RSSS-së kishte në konsideratë pasqyrën makroekonomike për periudhën 2014-2018. Supozohet se struktura ekonomike (komponentët e BPV-së si % e BPV-së së përgjithshme) të mbetet më masë të madhe e qëndrueshme. BPV-ja reale për vitin 2014 e krahasuar me vitin e kaluar pritet të ketë një rritje prej 4.1%. Rritja mesatare reale gjatë periudhës 2014-2018 pritet të

jetë 4.8%. Rritja pritet të ketë shtytje nga shtimi i konsumit, një kontribuues relativ i lartë në terma real (pas llogaritjes së efekteve të inflacionit).

Parashihet se përafërsisht 2% e rritjes mesatare të BPV-së (4.8%) në periudhën 2014-2018 do të rezultojë nga rritja reale në eksporte dhe investime. Përkundër viteve të mëparshme, rritja e tanishme e investimeve, pritet të ketë shtytje nga shtimi i investimeve private të projektuara përgjatë tre viteve të ardhshme, të bazuar në: riaktivizimin e ndërmarrjeve të privatizuara, shtimin e vazhdueshëm në regjistrimin e agro-bizneseve, dhe qasje më të madhe për financime pas anëtarësimit të Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe pas bashkëpunimit të mirë me institucionet tjera financiare.

Pas vlerësimit të tërë kostos së projektuar lidhur me RSSS-në të reflektuar në Kapitullin 7, Qeveria është e sigurt se do ketë mundësi të menaxhoj shtimin e rekomanduar në buxhetin e sektorit të sigurisë. Si një vend i pavarur i ri, ndikimi i luftës dhe efekti negativ në ekonomi, e ka lënë Kosovën me një pikënisje të ulët nga e cila të zhvilloj ekonominë e saj. Situata ishte natyrshëm e komplikuar ngase Qeveria ishte e detyruar të prioritzoj zhvillimin e institucioneve të reja shtetërore. Megjithatë, perspektiva ekonomike tani është më pozitive. Institucionet e reja shtetërore janë zhvilluar, janë duke u pjekur, dhe me përkrahjen e vazhdueshme ndërkombëtare do të vazhdojnë të marrin më tepër përgjegjësi në vitet në vijim. Parashikimet ekonomike janë më pozitive dhe bazuar në vazhdimin e thellimit të integritimit ekonomik në Evropë situata ekonomike për të gjithë qytetarët e Kosovës do të vazhdoj të përmirësohet. Në të vërtetë, Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) parasheh një vlerësim të rritjes së BPV-së deri 4% vetëm për vitin 2014. Mund jetë e nevojshme për të përshtatur prioritetet qeveritare për qëllime të zbatimit të rekomandimeve të e RSSS-së, por bazuar në projeksionet aktuale financiare kjo duhet të jetë e arritshme. Përgjatë periudhës së zbatimit të RSSS-së, Qeveria e Kosovës do bëjë vlerësimin e vazhdueshëm të progresit të reformës së sektorit të sigurisë dhe të bëjë përshtatjet buxhetore dhe financiare sipas nevojës, të përfshijë zbatimin e programeve të ngadalësuara ose të tej zgjatura përgjatë kohës, nëse parashikimet buxhetore kërkojnë ndryshime të tilla.

## **1.2.4 Transparenca**

Gjithashtu, RSSS ka qenë një proces dhe ishte i hapur për publikun në saje të takimeve dhe ndërveprimeve të shumta me shoqërinë civile dhe publikun. Në fakt, shoqëria civile ka organizuar në mënyrë të pavarur diskutime të hapura për RSSS-në dhe të ardhmen e sektorit të sigurisë në përgjithësi dhe zhvillimit të FSK-së në veçanti. Kontributi nga shoqëria civile ka ndihmuar në legjitimimin e procesit të RSSS-së.

## **Kapitulli 2. Procesi i RSSS**

### **Seksioni 2.1. Objektivat e RSSS**

Siç është theksuar më lartë, qëllimi i procesit të RSSS-së është kryerja e një studimi gjithëpërfshirës të institucioneve të sektorit të sigurisë përkitazi me nevojat e sigurisë së Kosovës, në një mënyrë transparente, legjitime, të përballeshme dhe llogaridhënëse. Definimi i roleve dhe misionëve kyçe të secilit institucion në sektorin e sigurisë, ndihmon qeverinë të jetë më efikase dhe të rrit (maksimizoj) shërbimet e saj ndaj qytetarëve në një mënyrë legjitime dhe financiarisht të përballeshme, duke mënjanuar shërbimet e dyfishuara dhe të mbivendosura, dhe duke shmangur konkurrencën ndërmjet institucioneve që ofrojnë siguri për qytetarët e Kosovës.

#### **Objektivat kryesore të RSSS-së janë:**

- Definimi i Objektiveve Strategjike të Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes të Republikës së Kosovës;
- Përcaktimi i Mjedisit Strategjik të Sigurisë, dhe rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme;
- Analizimi i kapaciteteve aktuale të institucioneve të sigurisë së brendshme;
- Përcaktimi i kapaciteteve që institucionet e sigurisë së brendshme do të kenë nevojë në të ardhmen;
- Përgatitja e rekomandimeve për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme dhe shpërbërjen e atyre të panevojshme (kërkuara), bazuar në analizën e RSSS-së për kapacitete;
- Ofrimi i udhëzimeve për Strategjinë e re Kombëtare të Sigurisë të Kosovës;
- Dhënia e rekomandimeve për ndryshimet e nevojshme legjislative;

Krijimi i institucioneve të sigurisë bazuar në rekomandimet e RSSS-së dhe bazuar në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë.

## **Seksioni 2.2. Kushtet e Punës (Termet e Referencës) dhe fazat e RSSS**

Bazuar në vendimin e Qeverisë të 21 Marsit 2012 për fillimin e procesit të RSSS-së, termat e referencës për RSSS janë hartuar dhe miratuar nga Komitetit Drejtues i RSSS-së. Këto Terma të Referencës përcaktojnë përgjegjësitë dhe detyrat për tu ndjekur gjatë procesit.

Termet e Referencës përcaktonin Komitetin Drejtues si organin përgjegjës vendimmarrës i cili përbehej nga:

1. Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës	Kryesues
2. Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar
3. Ministri i Punëve të Jashtme	Anëtar
4. Ministri i Financave	Anëtar
5. Drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës	Anëtar
6. Sekretari i Këshillit të Sigurisë së Kosovës	Anëtar
7. Këshilltari i Kryeministrit për Siguri	Anëtare
8. Këshilltari i Presidentes për Siguri	Anëtar
9. Kryesuesi i Komisionit të Kuvendit për Siguri	Anëtar
10. Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës	Anëtar
11. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës	Anëtar
12. Drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave	Anëtar

Secila Ministri ose Agjenci e përfshirë në RSSS kishte për obligim të krijoj grupe punuese në kuadër të institucioneve të tyre. Pastaj institucionet e sigurisë kanë zhvilluar skenarët për të identifikuar kërkesat potenciale të reja dhe mangësitë në kapacitete dhe aftësi të institucioneve të sektorit të sigurisë për të marr përsipër dhe reaguar ndaj krizave të mundshme në Kosovë. Përveç kësaj, Termat e Referencës përcaktonin detyrat e grupeve punuese dhe mënyrën e koordinimit të rezultateve të punës së tyre me koordinatorët tjerë nga Ministrinë tjera, grupit koordinues ndërministror (GKNM) dhe Komitetit Drejtues.

Termat e Referencës në veçanti theksonin fazat e procesit të RSSS-së. Në mënyrë që procesi të menaxhohet dhe drejtohet në mënyrë efikase dhe si rrjedhojë të vlerësohet, RSSS-ja përfshinte faza specifike.

**Fazat e procesit të RSSS-së ishin:**

Fazat e I-rë përfshinte krijimin e strukturës së procesit, caktimin e stafit për strukturën/procesin, përcaktimin e supozimeve planifikuese për procesin;

Faza e II-të përcaktoi objektivat strategjike të Republikës së Kosovës; politikat e sigurisë dhe mbrojtjes; analizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë të Republikës së Kosovës;

Faza e III-të përshkruan arkitekturën e ardhshme të sektorit të sigurisë, gjithashtu edhe të kapaciteteve dhe aftësive (të gjitha institucionet dhe agjencitë të identifikojnë sfidat e sektorit të sigurisë sikurse është përcaktuar paraprakisht);

Faza e IV-të përfshinte një analizë të hollësishme të aftësive aktuale të institucioneve dhe agjencive shtetërore të sigurisë, si dhe definimin e kapaciteteve të duhura dhe të panevojshme dhe pasqyrimin e kapaciteteve të nevojshme;

Faza e V-të përfshinte përcaktimin e roleve dhe misionëve, strukturat, emrat, dhe lokacionin/vendndodhjen e të gjitha institucioneve dhe agjencive të sektorit të sigurisë;

Faza e VI-të përfshinte analizimin e ndikimeve dhe përbalueshmërisë financiare;

Faza e VII-të kërkonte prezantimin dhe miratimin e rekomandimeve të RSSS-së;

Faza e VIII-të kërkon hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë të Republikës së Kosovës;

Faza e IX-të përfshinë ndryshimet e propozuara dhe miratimin e kornizës së re ligjore;

Faza e X-të përfshinë vazhdimin e zbatimit të ligjeve të reja dhe sipas nevojës ngritjes apo uljes së kapaciteteve institucionale

## **Kapitulli 3. Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Kosovës**

### **Seksioni 3.1 Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare**

Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Kosovës janë pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial; rendi kushtetues; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës; dhe stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare formojnë bazat për misionin dhe detyrat aktuale dhe të ardhshme të institucioneve në përgjithësi, dhe institucioneve të sigurisë në veçanti. Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare kategorizohen në këtë mënyrë:

1. Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial
  - 1.1. Ruajtja dhe mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial
  - 1.2. Përdorimi i mjeteve diplomatike në interes të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës
  - 1.3. Zhvillimi i kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes
  - 1.4. Menaxhim të integruar dhe kontroll të kufijve shtetëror
2. Rendi Kushtetues
  - 2.1. Ruajtja dhe fuqizimi i sundimit të rendit dhe ligjit në tërë vendin
  - 2.2. Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare
  - 2.3. Sigurimi i një sistemi gjyqësor të unifikuar dhe të pavarur
3. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik
  - 3.1. Zhvillimi i politikave për një treg të lire dhe ekonomi të qëndrueshme
  - 3.2. Një mjedis të qëndrueshëm për investimet e huaja dhe investimet vendore
  - 3.3. Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe ndërkombëtar
4. Jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës
  - 4.1. Mbrojtja e jetës dhe pronës
  - 4.2. Ngritja e mirëqenies sociale për të gjithë qytetarët
  - 4.3. Garantimi i sigurisë së gjithëmbarshme të qytetarëve
5. Stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

- 5.1. Integrimi dhe bashkëpunimi me strukturat e Bashkimit Evropian dhe Euro-Atlantike
- 5.2. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare
- 5.3. Pjesëmarrje aktive në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtar
- 5.4. Promovimi i Kosovës jashtë vendit.

## **Kapitulli 4. Mjedisi Strategjik i Sigurisë të Republikës së Kosovës**

### **Seksioni 4.1. Konteksti strategjik**

Republika e Kosovës është një vend i ri dhe i vogël në Ballkan dhe gjeografikisht kufizohet nga vende të vogla. Në një botë që është duke u globalizuar vazhdueshëm, Republika e Kosovës beson se nuk është immune ndaj rreziqeve dhe kërcënimeve të ndërlidhura me këtë zhvillim. Në njërën anë, mjedisi i sigurisë në Kosovë dhe rajonin tonë pritet të jetë më afirmativ, posaçërisht pas Marrëveshjes së prillit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Pra, ekziston një ndjenjë e zhvillimeve të rëndësishme dhe pozitive dhe mundësive për zhvillim ekonomik, paqe, stabilitet dhe siguri rajonale. Në anën tjetër, ekzistojnë vështirësi të shumta bashkëkohore që kërkojnë mirëkuptim, dialog dhe bashkëpunim. Në saje të këtij spektri të gjerë të kontekstit strategjik, institucionet e sigurisë në Kosovë kanë ndërmarr një qasje më të gjerë në aspektin e mjedisit strategjik të sigurisë duke pasur në konsideratë mjedisin global, rajonal, dhe të brendshëm.

### **Seksioni 4.2. Mjedisi Global i Sigurisë**

Kërcënimet konvencionale të luftës shtet kundër shtetit janë zvogëluar në masë të konsiderueshme në shekullin XXI. Në veçanti, konfrontimet konvencionale ndërmjet vendeve brenda dhe përreth hapësirës Euro-Atlantike kanë shumë pak gjasa të ndodhin në të ardhmen e afërt dhe afatmesme. Megjithatë, mjedisi global i sigurisë është formësuar nga fenomene të ndryshme, përfshirë tranzicionet e sistemeve politike në vende të ndryshme, vështirësitë ekonomike, dhe terrorizmi global. Gjatë viteve të fundit, mjedisi global i sigurisë është bërë më i paparashikueshëm dhe më sfidues, dhe do të vazhdojë të jetë kështu në vitet në vazhdim. Rreziqet, sfidat dhe kërcënimet globale që mund të ndikojnë në sigurinë e Kosovës rrjedhin nga pabarazia ekonomike, aktivitetet terroriste, krimi ndërshtetëror, armët nukleare dhe armë të tjera të shkatërrimit në masë, përhapja

e armëve të vogla, krimi i organizuar përfshirë trafikimin, dhe krimi kibernetikë. Në një botë të ndërvarur, Kosova si dhe shumë vende të tjera në mënyrë të direkte ose indirekte përballen me rreziqe të ngjashme.

### **Seksioni 4.3. Mjedisi rajonal i sigurisë**

Vendi dhe rajoni ynë, nga pikëpamja tradicionale kanë një hartë sigurie që është shumë më e favorshëm se sa që ishte 5 vite më herët. Siguria e vendit tonë gjithashtu është e favorizuar nga fakti se Republika e Kosovës promovon raporte të mira fqinjësore me të gjitha vendet e Evropës Juglindore. Kosova nuk ka synime territoriale ndaj asnjërit prej fqinjëve dhe pret nga fqinjët e saj politikë dhe qëndrime të njëjta shtetërore. Pavarësisht pengesave tradicionale të mjedisit të sigurisë, ekziston një përmirësim i ndjeshëm i sigurisë rajonale dhe se ka pritje se kjo klimë do të përmirësohet edhe më tej. Sidomos, relaksimi dhe normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë ka filluar dhe është duke vazhduar në frymën e mos konfrontimit dhe integritit Evropian. Politikat e konfrontimit ndërmjet vendeve gradualisht po zëvendësohen me një frymë të re të bashkëpunimit dhe konkurrencës ekonomike. Prania e BE-së, NATO-së dhe organizatave të tjera në rajon vazhdon të mbetet një faktor i ndërtimit të paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit rajonal.

Rajoni ynë tani përbëhet prej vendeve aleate, dhe atyre që janë pjesë ose aspirojnë të bëhen anëtare të BE-së dhe NATO-së. Shumë vende në rajon kanë iniciuar reformat e sigurisë dhe mbrojtjes. Objektiva kryesore e reformës së sektorit të sigurisë të këtyre vendeve është siguria dhe mbrojtja në kuadër të kornizës së vetëmbrojtjes dhe mbrojtjes e sigurisë kolektive, e cila është duke u reflektuar përmes zhvillimit të forcave të vogla profesionale, me kapacitete plotësuese të mbrojtjes. Ky është gjithashtu synimi i Republikës së Kosovës.

Bashkëpunimi rajonal pritet që gjithnjë e më shumë të zgjerohet në fushat politike, ekonomike dhe të sigurisë. Si asnjë herë më parë, ne jemi duke kryer ushtrime të përbashkëta rajonale, ofrojmë ndihmë të ndërsjellë në emergjenca civile, kemi vendosur formate të ndryshme bashkëpunimi dhe fusha të tjera në kuadër të fuqizimit të bashkëpunimit rajonal. Republika e Kosovës synon të zgjeroj këtë bashkëpunim me të gjitha vendet e rajonit.

Republika e Kosovës është e përkushtuar të luftoj fenomenet negative që mund ta kërcënojnë sigurinë e saj nga një kontekst rajonal. Rreziqet dhe kërcënimet rajonale janë shpërndarja e



armëve të vogla, ekstremizmi etnik dhe fetar, krimi i organizuar përfshirë edhe trafikimi, krimet ekonomike, proliferimi i armëve të shkatërrimit masiv, jo stabiliteti politik rajonal, epidemitë dhe katastrofat natyrore.

#### **Seksioni 4.4. Mjedisi i brendshëm i sigurisë**

Përmes procesit të RSSS-së janë identifikuar rreziqe të shumta të brendshme, përfshirë ekstremizmi etnik dhe fetar, katastrofat natyrore, municione të pashpërthyer/mjete të improvizuara shpërthyes (UXO/IED), shpërndarja e armëve të vogla, krimi i organizuar, zhvillimi i pa mjaftueshëm ekonomik, papunësia, institucione të zbehta të sigurisë/drejtësisë, korrupsioni, kufij të kontestuar/të pazgjedhur, dhe keqpërdorim i burimeve natyrore. Të gjitha këto rreziqe mund të kërcënojnë sigurinë, sundimin e ligjit dhe dëmtojnë imazhin e vendit jashtë.

##### **4.4.1. Katastrofat natyrore – katastrofat e shkaktuara nga njeriu**

Kosova duke pasur një klimë kontinentale dhe e gjendur në një zonë aktive sizmike, ballafaqohet me katastrofa natyrore, përfshirë dridhje të tokës, vërshime, dhe borë në zona të thella rurale. Nganjëherë, katastrofat natyrore janë përtej kontrollit të institucioneve të Kosovës. Aksidentet industriale ose pakujdesia njerëzore, qofshin ato aksidente ose katastrofa nga ajri apo toka, eliminimi/lehtësimi i ndotjes me përmasa të mëdha të ajrit dhe tokës në vend, si dhe sëmundje të ndryshme infektuese, zjarret, ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike, janë identifikuar si sfida të brendshme të sigurisë.

##### **4.4.2 Mjete të pashpërthyer/mjete të improvizuara shpërthyes (UXO/IED)**

Duke marr parasysh përdorimin e minave tokësore dhe bombave të ndryshme në luftën e fundit, ka qenë e pashmangshme që qytetarët e Kosovës të mos ndikohen në mas të madhe gjatë dhe pas periudhës së luftës. Mjetet e pashpërthyer dhe mjetet e improvizuara shpërthyes kanë pasur ndikim të madh negativ tek qytetarët. Sipas dokumentit të ITF Rritja e Sigurisë Njerëzore, problemi i minave dhe bombave kasetë në territorin e Kosovës rrjedh nga rrethanat e vitit 1999 dhe fushata ajrore e NATO-së. Prandaj, ekzistojnë ende dhjetëra zona të rrezikshme në Kosovë të cilat do të kenë nevojë të pastrohen. Rreziku për jetën e civilëve të do jetë i madh deri sa të mos pastrohen nga territori i Kosovës të gjitha minat tokësore dhe mjetet e pashpërthyer.

#### **4.4.3 Ekstremizmi**

Lëvizjet ekstremiste jashtë Kosovës pritet të shtohen në të ardhmen në nivelin nacional, rajonal dhe ndërkombëtar dhe të ndikojnë në mjedisin e sigurisë brenda Kosovës. Ato mund të jenë të natyrave, kulturave, ideologjive dhe qëllimeve të ndryshme dhe mund të përdorin forma që janë shumë të sofistikuara, teknologji më të avancuar, më taktike, metoda destabilizuese, dhe ndikim të mediatik në publik. Niveli i rrezikut mund të rritet nëse ato janë të përkrahura nga shtete ose vende të dështuara që për qëllime të ndryshme synojnë të zhvendosin kundërshtarët, problemet dhe krizat e tyre jashtë vendeve të tyre. Kështu, në mënyrë që të përmirësoj mjedisin e sigurisë, Republika e Kosovës do të bashkëpunoj me vendet fqinje për të luftuar çfarëdo forme ose ekstremizëm, qoftë ai politik, fetar apo etnik.

#### **4.4.4 Shpërndarja e armëve të vogla**

Është konfirmuar nga burime të ndryshme dhe Ministria e Punëve të Brendshme se ende ekziston një numër i madh i njësisive të vlerësuara të Armëve të vogla dhe të lehta në Kosovës dhe një numër i madh i tyre në posedim ilegalr të qytetarëve të thjeshtë dhe grupeve të tjera. Duke marrë parasysh mjedisin e brendshëm të sigurisë, Kosova ka nevojë të zhvilloj dhe/ose të përmirësoj kapacitetet e veta për tu ballafaquar më një çështje të tillë shqetësuese.

#### **4.4.5 Krimi i organizuar**

Një rrezik tjetër mund të jetë krimi i organizuar, i cili nuk është i kufizuar vetëm brenda territorit të Kosovës por është një problem transnacional/ndërshtetëror. Si i tillë kërcënon dhe dëmton sundimin e ligjit dhe perspektivën e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

#### **4.4.6 Korrupsioni**

Një rrezik tjetër është korrupsioni. Korrupsioni minon besimin në institucionet publike dhe ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik dhe integrimet Euro-Atlantike.

## **Seksioni 4.5. Kërcënimet jo-konvencionale**

Këto rreziqe dhe kërcënime në rritje synojnë konfrontimin ndërmjet shteteve në një anë dhe akterëve kundërshtues jo-qeveritar në anën tjetër. Ato kanë objektiva më të kufizuara se sa ato konvencionale dhe mund të rrjedhin nga lëvizjet ekstremiste, shtetet e dështuara, aktivitetet ilegale dhe kriza të tjera të ndryshme. Kërcënime të tilla në zhvillim janë armët e shkatërrimit në masë, terrorizmi dhe krimi kibernetikë.

### **4.5.1. Armët e shkatërrimit në masë**

Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë (kimike, biologjike, radiologjike dhe nukleare) dhe pajisja që i aktivizon ato, përbënë një kërcënim të madh për sigurinë globale, posaçërisht kur përpjekjet për përhapjen dhe posedimin e tyre ndërmerren nga vende të papërgjegjshme ose organizata terroriste dhe kriminale.

### **4.5.2. Terrorizmi**

Pozita gjeografike dhe aspiratat Euro-Atlantike dhe bashkëpunimi i ngushtë me vendet që janë pjesë të organizatave Euro-Atlantike e bënë Kosovën të cenueshme ndaj terrorizmit. Kosova konsideron terrorizmin dhe aktet e terrorizmit jo vetëm si një rrezik dhe kërcënim ndaj vetvetes por edhe ndaj miqve dhe aleatëve të saj. Republika e Kosovës është e gatshme dhe bënë përpjekje të bashkëpunoj me të gjitha vendet për të parandaluar dhe zvogëluar terrorizmin ndërkombëtar dhe aktivitetet terroriste.

### **4.5.3. Krimi Kibernetikë**

Besimi i shtuar në sistemet komunikuese dhe informative i ka bërë shtetet të cenueshme ndaj sulmeve kibernetike të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha në sistemet kombëtare, rrjetet dhe infrastrukturën e informimit, ekonomisë, bankave, bizneseve dhe trafikut ajror dhe tokësor. InfoSecurity Europe paralajmëron se qindra mijëra sulme kibernetike ndodhin në baza ditore dhe po bëhen më të ashpra çdo ditë e më tepër. Pritet që kërcënimi i sulmeve kibernetike do të shtohet gjatë viteve në vijim. Si tillë, mund të shkaktoj dëme ekstreme në administratën publike, ekonominë dhe infrastrukturën e Kosovës. Krimi kibernetikë konsiderohet të jetë inkurajuar dhe

shkaktuar nga një agjendë politike dhe aktivitete kriminale. Në këtë mënyrë, krimet kibernetike paraqesin një rrezik ndaj sigurisë, stabilitetit dhe funksionimit të shtetit.

## **Kapitulli 5. Politikat e Sigurisë dhe Mbrojtjes të Republikës së Kosovës**

### **Seksioni 5.1. Koncepti i Politikave të Sigurisë dhe Mbrojtjes**

Republika e Kosovës synon të ndërtoj një sistem funksional dhe modern të sigurisë. Si një vend i vogël dhe rishtazi i pavarur, siguria e Kosovës do të bazohet në zhvillimin e kapaciteteve të mjaftueshme të institucioneve të sigurisë. Gjithashtu, Republika e Kosovës synon të bëhet pjesë e politikave Euro-Atlantike duke qenë përfitues si dhe kontribuues. Prania e forcave të KFOR-it dhe strukturave të tjera ndërkombëtare të sigurisë në territorin e Republikës së Kosovës do të ofroj kohë për të zhvilluar një bazë të mirë të kapaciteteve të brendshme të sigurisë, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Politikat e sigurisë adresohen nga perspektiva e brendshme, rajonale dhe globale. Politikat e sigurisë janë të ndërlidhura direkt ose indirekt me ruajtjen dhe promovimin e interesave kombëtare. Këto politika do të arrihen përmes planifikimit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Niveli i arritjeve të tyre do të bëhet në pajtim me prioritetet e interesave kombëtare, me nevojat njerëzore, materiale dhe financiare të ndërlidhura më to dhe mundësitë konkrete për zhvillimin e Republikës së Kosovës në periudhën afatmesme.

### **Seksioni 5.2. Politikat e brendshme për Sigurinë e Republikës së Kosovës**

Shqetësimi kryesor i Republikës së Kosovës është siguria e qytetarëve të saj duke konsideruar të gjitha elementet themelore dhe njerëzore.

#### **5.2.1. Nxitja e një mjedisi të sigurt për qytetarët e Kosovës**

- Mbrojtja e qytetarëve dhe integritetit territorial të Kosovës;
- Fuqizimi i sundimit të ligjit, pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe fuqizimi dhe zbatimi i ligjeve;
- Promovimi i demokracisë funksionale, për të zhvilluar më tej pluralizmin politik, për të nxitur ekonomin e tregut të lire dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave kombëtare;

- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë dhe mbrojtjes;
- Harmonizimi i legjislacionit në pajtim me standardet e BE-së dhe NATO-së;
- Zhvillimi, krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve të inteligjencës në interes të sigurisë, luftimit të terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Zhvillimi i kapaciteteve të mjaftueshme të infrastrukturës kombëtare për lëvizjen e personave dhe mallrave brenda dhe me vendet fqinje;
- Investimi në edukim dhe shkollim;
- Përkrahje të vazhdueshme të shërbimeve të kujdesit shëndetësor për popullatën;
- Inkurajimi i zhvillimit të hulumtimeve shkencore dhe zhvillimi e përdorimi i teknologjive të reja;

### **5.2.2. Krijimi i strukturave të sigurisë dhe mbrojtjes**

- Avancimi dhe themelimi i një sistemi mbrojtës të sigurisë kombëtare me kapacitete të nevojshme në fushën e diplomacisë, shërbimit të inteligjencës, mbrojtjes dhe sigurisë;
- Funksionimi i institucioneve të mbrojtjes dhe sigurisë në konceptin e ‘përbashkët’, ndërinstytucional dhe shumëkombësh, me pjesëmarrje të gjerë të kapaciteteve ushtarake dhe civile, si dhe agjencive qeveritare dhe jo qeveritare;
- Transformimi gradual i FSK-së në një organizatë me mision të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës;
- Si një prej parimeve themelore të një vendi demokratik, institucionet e sigurisë të Republikës së Kosovës i përmbahen parimit të kontrollit civil dhe demokratik të autoriteteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje si dhe aktet ndërkombëtare ligjore.

## **Seksioni 5.3. Politikat rajonale për siguri të Republikës së Kosovës**

### **5.3.1. Kontributi në sigurinë dhe stabilitetin rajonal**

- Republika e Kosovës kontribuon në procesin e integritit dhe bashkëpunimit rajonal, ndjek anëtarësimin me të drejta të plota dhe obligime dhe merr pjesë aktivisht në

organizata dhe iniciativa rajonale;

- Zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për tu ballafaquar me emergjencat civile brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
- Zhvillimi i kapaciteteve për ngritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit rajonal;

## **Seksioni 5.4. Politikat Globale për Siguri të Republikës së Kosovës**

### **5.4.1. Kontributi në sigurinë ndërkombëtare dhe globale**

- Anëtarësimi dhe integrimi i Republikës së Kosovës në institucionet Evropiane, Euro-Atlantike dhe globale, në veçanti NATO/BE/OSBE/OKB;
- Përgatitja e kapaciteteve për të kontribuar në operacione paqësore dhe humanitare, dhe misione të tjera ndërkombëtare të NATO/OSBE/BE/OKB.

## **Kapitulli 6. Arkitektura e ardhshme e sektorit të sigurisë të Republikës së Kosovës**

Grupi Punues Ndërministror ka diskutuar arkitekturën e ardhshme të sektorit të sigurisë të Republikës së Kosovës dhe propozon arkitekturën e sigurisë si më poshtë. Kjo është zhvilluar në bazë të institucioneve ekzistuese, duke njohur faktin se ato kanë dhënë kontribut të çmueshëm në sigurinë e Republikës së Kosovës. Disa ndryshime janë të nevojshme, për shembull krijimi i një organi të ri të Kuvendit që do të sigurojë mbikëqyrjen e Ministrisë së re të Mbrojtjes.

## **ARKITEKTURA E ARDHSHME E SEKTORIT TË SIGURISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

<b>Niveli mbikëqyrës</b>	<b>Niveli ekzekutiv</b>	<b>Niveli i institucioneve të sigurisë</b>
--------------------------	-------------------------	--

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioni Parlamentar për Siguri;</li> <li>- Komisioni Parlamentar për Mbrojtje;</li> <li>- Komisioni Parlamentar për Inteligjencë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli i Sigurisë së Kosovës</li> <li>- Ministria e Punëve të Jashtme</li> <li>- Ministria e Punëve të Brendshme</li> <li>- Ministria e Mbrojtjes</li> <li>- Ministria e Drejtësisë</li> <li>- Ministria e Financave</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Forcat e Armatosura të Kosovës</li> <li>- Policia e Kosovës</li> <li>- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë</li> <li>- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave</li> <li>- Shërbimi Korrektues</li> <li>- Doganat e Kosovës</li> <li>- Sekretariati i KSK</li> <li>- Agjencia e Aviacionit Civil</li> </ul>
--	--	---

## **Kapitulli 7. Analiza e Ministrive të sektorit të Sigurisë**

### **Seksioni 7.1. Ministrinë e Analizuara nga RSSS**

Për të fuqizuar faktin se Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë është nxitur për të bërë përpjekje për një bashkëpunim të shtuar ndërqeveritar dhe ndërministror, procesi ka marr parasysh të gjitha ministrinë e sektorit të sigurisë. Procesi i RSSS ka studiuar jo vetëm institucionet themelore të sektorit të sigurisë, sikurse FSK, policinë, shërbimet e inteligjencës, por gjithashtu edhe ministrinë përgjegjëse të FSK-së, punëve të jashtme, punëve të brendshme, drejtësisë, financave, shëndetësisë, arsimit, mjedisit dhe infrastrukturës. Ky seksion do të shqyrtoj ministrinë dhe agjencitë e ndryshme dhe për secilën ministri dhe agjenci do të përshkruaj bazën ligjore, rolin dhe misionin aktual, si mund të ndryshoj roli dhe misioni i tij në të ardhmen, dhe të ofroj rekomandime sa i përket hapave që secila ministri dhe agjenci do të duhet të ndërmarr në mënyrë që të përmbush udhëzimet e përcaktuara në RSSS.

#### **7.1.1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK)**

*Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësit e tij.* Këshilli i Sigurisë së Kosovës (KSK) është krijuar në vitin 2008 me rol këshillues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në

Kosovë dhe kontributin e saj në stabilitetin rajonal. Bazat ligjore të KSK-së mund të gjenden në Kushtetutë dhe Ligjin Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

*Roli dhe misioni i tanishëm.* Neni 127,1 i Kushtetutës në mënyrë të qartë autorizon KSK-në për të zhvilluar Strategjinë e Sigurisë të Republikës së Kosovës, duke vepruar për këtë qëllim në bashkëpunim me Presidentin e Kosovës dhe Qeverinë. Kushtetuta përcakton se KSK kryesohet nga Kryeministri, me mbështetje të Qeverisë, përveç në gjendje të jashtëzakonshme, KSK kryesohet nga Presidenti i Kosovës (Neni 127.2). Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, KSK ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me gjendjen e jashtëzakonshme (neni 131.8). Në situata të tilla, KSK kërkohet të ushtroj funksionet ekzekutive në bashkëpunim të plotë me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.

KSK ka rol këshillues për të gjitha çështjet që ndërlidhen me sigurinë në Kosovë. Roli i KSK-së është të bëjë rekomandime për politikën dhe strategjitë e sigurisë, dhe të ofroj informacione dhe vlerësime rreth gjendjes së sigurisë në Kosovë për t'i mundësuar Qeverisë së Kosovës të marr vendime të bazuara në informata lidhur me çështjet e sigurisë. Gjithashtu, KSK kërkohet të siguroj komente me shkrim për të gjitha projekt ligjet që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë dhe institucionet e tij; të rishikoj planin dhjetëvjeçar për Forcën e Sigurisë së Kosovës; të rishikoj platformën vjetore të inteligjencës dhe prioritetet strategjike për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë; të rishikoj politikën dhe planet strategjike të paraqitura nga Ministri i Punëve të Brendshme që kanë të bëjnë me policinë e Kosovës dhe Shërbimin Doganor; të rishikoj politikën e jashtme të sigurisë, draftet e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me sigurinë dhe krijimin e marrëdhënieve ndërmjet agjencive shtetërore të sigurisë dhe agjencive ose organizatave homologe të jashtme; këshillon Presidentin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës lidhur me propozimet për vendosjen e institucioneve dhe agjencive të sigurisë në operacione jashtë territorit të Kosovës.

KSK ka Sekretariatit e vet, i cili udhëhiqet nga Sekretari i KSK-së. Funksionet Sekretariatit të KSK-së janë: përgatitja e raporteve dhe analizave periodike për çështjet që kanë të bëjnë me politikën dhe sigurinë për Qeverinë e Kosovës dhe për KSK-në; koordinimi i zhvillimit strategjik dhe linjave të veprimit të sigurisë në Kosovë, përfshirë ngritjen e kapaciteteve, si dhe mbështetjen administrative, teknike dhe funksionale për KSK-në, Qendrën e Situatave,



Komisionin për Inteligjencë, dhe komisione të tjera që mund të formohen nga ana e KSK-së në pajtim me Ligjin për themelimin e KSK-së. Përveç Sekretariatit, KSK gjithashtu mbështetet edhe nga Qendra e Situatave, përgjegjësia e të cilës është të bëjë paralajmërim me kohë të situatave, të koordinoj aktivitetet reaguese operationale në mbarë Kosovën dhe të shërbej si një qendër operative për grumbullimin e informatave, analizave themelore, dhe mbështet menaxhimin e krizave.

Roli dhe misioni në të ardhmen. KSK do të vazhdoj të ketë rol dhe mision të njëjtë, sikurse është përcaktuar me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, me kompetenca të zgjeruara, të propozuara nga Kryeministri ose Presidenti sipas nevojës. Planifikohet përmirësimi i bashkëpunimit me institucionet në fusha të ndryshme të sigurisë për të adresuar në mënyrë efektive dhe efikase çështjet e sigurisë në Kosovë.

### Analiza

#### **Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**

*Statusi i Sekretariatit:* Sekretariati i KSK-së aktualisht është pjesë përbërëse e Zyrës së Kryeministrit. Kjo gjendje nuk është në përputhshmëri me legjislacionin aktual. Është argumentuar se Sekretariati i KSK-së duhet të njihet si një zyre e ndarë, që ofron shërbime të drejtpërdrejta dhe ekskluzive për KSK-në, si një organ i pavarur administrativ me buxhet vetanak në pajtim me nenin 26 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

*Kapacitetet:* Me marrjen e kompetencave të reja në fushën e sigurisë, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës duhet të shtoj ngritjen e kapaciteteve të brendshme në mënyrë që të përmbush mandatin e vet.

*Personeli:* Stafi i Sekretariatit të KSK-së për një kohë të gjatë është ballafaquar me hapësirë të jashtëzakonshme dhe një mjedis të papërshtatshëm për punë.

#### **Qendra e Situatave e Këshillit të Sigurisë së Kosovës**

Ndonëse Qendra e Situatave është shfrytëzuar vetëm një herët gjatë pesë viteve të fundit, drejtohet dhe funksionon përgjatë 24 orëve gjatë tërë javës. Shumica e institucioneve të sigurisë

kanë Qendrat e Situatave përkatëse. Duke qenë së Qendra e Situatave e KSK-së është shfrytëzuar vetëm në raste të rralla, personeli që mund të shfrytëzohet për detyra dhe përgjegjësi të tjera mbushin me personel Qendrën e Situatave.

### Rekomandimet për KSK

- Qendra e Situatave duhet të riformatohet/ridisajnohet si një ‘hapësirë e zbrazët (empty rom)’ për tu shfrytëzuar gjatë një situatë emergjente si një hapësirë për menaxhim të situatave nga përfaqësues të të gjitha institucioneve të sigurisë. Në situata normale, Qendra e Situatave e KSK-së do të vazhdoj të ekzistoj me personelin bazë, ku pajisjet dhe zyret do të mbesin aty dhe do të mirëmbahen nga stafi i Sekretariatit. Mirëpo, në gjendje të jashtëzakonshme Qendra e Situatave do të aktivizohet dhe të plotësohet me staf nga të gjitha institucionet e nevojshme të sigurisë për atë situatë të caktuar (pa implikime buxhetore);
- Funkcionet e raportimit dhe mbledhjes së informatave aktualisht kompetencë e Qendrës së Situatave mund t’i transferohen Sekretariatit me pasojë që Sekretariati do të bëhej pikë reference për procesim të informatave, raportim dhe analizë (pa implikime buxhetor);
- Ligjet e Kosovës që aplikohen për shkëmbim të informatave me Sekretariatit të KSK-së të harmonizohen (pa implikime buxhetore);
- Statusi i personelit të Sekretariatit të KSK-së të ri-definohet. Një status më i përshtatshëm do të ishte ai i nëpunësit publik, siç përcaktohet me Ligjin për Shërbimin Civil. Kushtet e punësimit dhe pagave të rregullohen drejtpërdrejt me Ligjin për KSK-në (kjo do të kushtojë 532.930 Euro gjatë periudhës 2014-2018).

### **7.1.2. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësit e saj. Që nga themelimi në vitin 2008, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) kryen misionin e saj në bazë të këtij legjislacioni: Ligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës; Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës; Ligji për statutin, imunitetet dhe privilegjet e Misionëve diplomatike dhe konsullore dhe personelit në Republikën e Kosovës dhe të Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake dhe

Personelit të saj; Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare; Ligji për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare.

MPJ, aktualisht është në fazën e iniciativës legislative për hartimin e Ligjit ‘për Ministrinë e Punëve të Jashtme’ – si një ligj unik dhe gjithëpërfshirës, i cili është i bazuar në parimin “një institucion një shërbim.” Qëllimi i këtij ligji është të rregulloj aktivitetet e shërbimit të jashtëm dhe statusin diplomatik si një pjesë e ndarë nga shërbimi civil, si dhe organizimin, koordinimin dhe funksionimin e institucioneve përgjegjëse për politikën e jashtme të Republikës së Kosovës. Ky ligj pritet të hyj në fuqi gjatë vitit 2014, por nuk ka ndikim për rolin dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Jashtme në RSSS, përveç koherencës së brendshme dhe institucionale.

Roli dhe Misioni i tanishëm. Misioni i Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) është formulimi dhe zbatimi i politikës së jashtme të Kosovës, mbrojtja e interesave të Kosovës në raport me vendet tjera dhe organizatat ndërkombëtare, përfaqësimi i Kosovës në shtetet e jashtme, ruajtja dhe mbrojtja e imuniteteve dhe privilegjeve të misioneve diplomatike dhe personave të përkufizuara ndaj tyre sipas ligjeve dhe konventave ndërkombëtare, dhe zhvillimin dhe koordinimin e politikave në lidhje me vendet tjera. Ministria e Punëve të Jashtme promovon dhe mbron politikat kombëtare, kulturore dhe ekonomike të Kosovës në botë. Në kuadër të kësaj, sipas legjislacionit të lartpërmendur përveç organizimit dhe zbatimit të politikës së jashtme, MPJ ka përgjegjësi të rëndësishme të koordinimit të institucioneve kombëtare dhe qeveritare që merren me çështje të marrëdhënieve ndërkombëtare, përkatësisht iniciimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga ministritë e linjës dhe miratimin në parim nga ana e Qeverisë, pas rekomandimit të MPJ-së. MPJ gjithashtu kërkohet të lëshoj autorizime për kryerjen e veprimeve lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare, dhe të jep pëlqimin për negociimin e marrëveshjeve të tilla.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Roli dhe misioni qendror i MPJ-së do të mbetet i pandryshuar gjatë periudhës 2014-2018. Sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërmjet agjencive, në vitin 2013 MPJ ka nënshkruar me MFSK-në një Nivel Shërbimi për Atashe që do të krijoj një bazë të qëndrueshme për shfrytëzimin ndërinstitucional të Misioneve Diplomatike të Kosovës. Përgjegjësitë, detyrat dhe sfidat e MPJ-së do të vazhdojnë të fokusohen në mbështetjen e institucioneve të tjera në lidhje me zhvillimet e ardhshme politike që priten të ndodhin me

anëtarësimin e plotë të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare gjatë periudhës 2014-2018.

Analiza. Gjatë vitit 2013 MPJ ka ngritur kapacitete të reja në kuadër të strukturës organizative,, përmes krijimit të Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të nevojshme të politikave drejt integritit në NATO dhe ofrimit të rekomandimeve për iniciimin e marrëveshjeve një paleshe dhe shumëpaleshe në fushën e sigurisë. Në realitet, përfshirja aktive e Republikës së Kosovës në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtar të sigurisë vazhdon të jetë një prioritet që do të ndihmojë Kosovën drejt integritit në Bashkimin Evropian dhe NATO. Synim i Republikës së Kosovës është që t'i bashkohet strukturave Euro-Atlantike. Gjithashtu ky është emërtuesi më i fuqishëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe një shenjë e gatishmërisë dhe konfirmimit që të bëhet një eksportues i sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare. Mbrojtja e interesave dhe sigurisë kombëtare është qenësore për mirëqenien dhe sigurinë e qytetarëve të Kosovës, për garantimin e stabilitetit dhe prosperitetit të Kosovës dhe aftësisë për të demonstruar rolin e saj si mbrojtës dhe garantues i sigurisë. Siguria kombëtare e Kosovës është ngushtë e lidhur me sigurinë rajonale dhe më gjerë të asaj Euro-Atlantike. Kosova synon të fuqizojë sigurinë e saj përmes politikës bashkëpunuese në mbrojtje dhe siguri me NATO-në dhe BE-në dhe sigurisht përmes nismave bashkëpunuese rajonale të sigurisë.

Niveli i bashkëpunimit rajonal është duke u rritur çdo ditë përmes organizimeve rajonale në fushën e sigurisë. Kosova tashmë është anëtare e plotë e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (KBR) dhe synon këto organizata rajonale: Kartën e Adriatikut –A5, Iniciativa e Adriatikut dhe Jonit –AII, Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim – RACVIAC, Iniciativa për Bashkëpunim e Evropës Juglindore –SECI, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore – SEEC, Procesi i Bashkëpunimit të Ministrave të Mbrojtjes së Evropës Juglindore – SEDM, Iniciativa e Evropës Juglindore për NATO – SEEI dhe Zyra Qendrore e NATO-së për Evropë Juglindore – SEEC.

Anëtarësimi i plotës në këto organizata do të kontribuojë në bashkëpunim në fusha të ndryshme dhe do të fuqizonte partneritetet në luftën kundër korrupsionit, krimin e organizuar, trafikimit të armëve dhe qenieve njerëzore, dhe bashkëpunimin në sigurinë e kufijve. Për të dhënë kontributin e plotë, Kosova ndjek rrugën e anëtarësimit të plotë në INTERPOL, EUROPOL dhe mekanizma të tjerë të ngjashëm.

Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me MFSK-në dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme planifikon të avancoj agjendën bashkëpunuese duke shtuar numrin e Atasheve Policor dhe të Sigurisë në Misionet Diplomatike të Republikës së Kosovës.

Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga 104 shtete anëtare të OKB-së. Procesi i njohjes ndërkombëtare është prioritet për MPJ-në. Ky proces i shtet-ndërtimit është i bazuar në parimin e demokracisë, diversitetit etnik dhe sekularizmit.

Republika e Kosovës promovon dhe mban marrëdhënie miqësore në rajon. Kosova nuk ka synime territoriale ndaj ndonjë shteti në rajon dhe nuk ka synime për bashkim me ndonjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti. Kosova pret reciprocitet nga fqinjët e saj. Republika e Kosovës ka marrëdhënie të shkëlqyeshme me të gjitha vendet e rajonit përveç Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës. Në këtë kontekst, Kosova mbetet e përkushtuar të mbyll konfliktin historik me Serbinë përmes procesit të dialogut për normalizim të marrëdhënieve që ka filluar në Bruksel në tetor të vitit 2012, dialog ky i lehtësuar nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian. Në këtë proces të dialogut të dy vendet kanë arritur një numër marrëveshjesh të rëndësishme që kanë vendosur baza konkrete për marrëveshjen e 19 prillit 2013.

Aktualisht Republika e Kosovës ka 21 misione diplomatike dhe 14 misione konsullore, dhe ka nënshkruar 150 marrëveshje një paleshe dhe shumëpalëshe. MPJ planifikon të shtoj numrin e Misioneve Diplomatike dhe Konsullore duke filluar në vitin 2014. Në këtë moment, nuk është e mundur të projektohet numri i misioneve diplomatike që mund të hapen në të ardhmen, kështu që implikimet financiare të ndërlidhura me hapjen e misioneve diplomatike janë të panjohura.

#### Rekomandimet për MPJ-në

- Ndjekja e rrugës së anëtarësimit në organizata dhe nisma rajonale;
- Ndjekja e rrugës së anëtarësimit të plotë dhe aktiv në INTERPOL, EUROPOL dhe mekanizma të tjerë të ngjashëm;
- Ngritja e numrit të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore si dhe përfaqësimi i institucioneve të tjera të Kosovës në kuadër të këtyre misioneve.

### **7.1.3. Ministria e Forcës së Sigurisë (MFSK)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësinë e saj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 73, paragrafi 1 (2), nenin 84, paragrafi 12 dhe 20, neni 126 dhe 131, paragrafi 7 ofron kornizën ligjore për themelimin, funksionin dhe kompetencat e MFSK-së dhe FSK-së, përfshirë këtu zinxhirin e kontrollit demokratik civil.

Bazuar në këtë, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka miratuar tri ligje kryesore në vitin 2008: Ligjin Nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës me ndryshim plotësim të ligjit me Ligjin Nr. 03/L-107; Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës me ndryshim plotësim të ligjit me Ligjin Nr. 03/L-108 dhe Ligjin Nr. 03/L-082 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Më qëllim që korniza ligjore të jetë e kompletuar për misionin e FSK-së të përcaktuar në Kushtetutë, MFSK-ja ka hartuar ligje të tjera që tanimë janë në fuqi: Ligji Nr. 03/L-213 për Komponentin Rezervë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-089 për Deminimin Humanitar, Ligjin Nr. 04/L-84 për Pensione për Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe Ligjin Nr. 04/L-177 për Dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës Jashtë Vendit.

Roli dhe misioni i tashëm. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë tërësisht vullnetare e përbërë nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si instrument i sigurisë, është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. FSK është e dizajnuar dhe e përgatitur për të përmbushur funksione të sigurisë që nuk janë të përshtatshme për policinë apo organizata të tjera të sundimit të ligjit. Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë. Sipas ligjeve në fuqi misionet e saj janë:

- Pjesëmarrja në operacione për reagim ndaj krizave, duke përfshirë operacione në mbështetje të paqes, përfshirë këtu edhe operacione brenda territorit të Republikës së Kosovës si dhe jashtë saj, kudo që ftohen për këtë qëllim.
- Të ndihmoj autoritet civile në reagim ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave duke përfshirë gatishmërinë për reagim regjional dhe ndërkombëtar.
- Të punojë në asgjësimin e mjeteve shpërthyese.

- T'i ndihmojë autoritetet civile në operacione të mbrojtjes civile.

FSK Sipas legjislacionit ekzistues të Republikës së Kosovës, në emergjencat civile ka rol mbështetës. Sidoqoftë, FSK-ja në realitet e ka rolin kryesor të reaguesit të parë në shumë raste të emergjencave në Kosovë sepse ka kapacitete dhe është e trajnuar për t'i kryer ato detyra. Bazuar në të gjeturat e RSSS-së, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) do të marrë përgjegjësitë primare si reagues i parë në emergjenca civile në vitin 2018. Pas kësaj periudhe tranzicionale, forca e ardhshme do të ketë vetëm rol mbështetës në situata të emergjencave civile.

*Roli dhe misioni në të ardhmen.* Bazuar në analizën e thellë dhe metodike të bërë gjatë procesit të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë, është shfaqur nevoja për zhvillimin e kapaciteteve për të marrë përsipër detyra shtesë të sigurisë, në përputhje me sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, vlerësimi i ambientit të sigurisë dhe në veçanti vlerësimi i kërcënimeve dhe rreziqeve kanë dëshmuar se rreziku për konflikt ndër-shtetëror është shumë i ulët dhe se Republika e Kosovës kryesisht ballafaqohet me kërcënime të sigurisë njerëzore/humane. Prandaj, duke pasur parasysh nevojën për zhvillimin e kapaciteteve për të marrë përsipër detyra shtesë të sigurisë, në përputhje me sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, nivelin e ulët të rrezikut të konfliktit ndër-shtetëror, prezencën e KFOR-it si dhe rreziqe që kryesisht kanë të bëjnë me siguri njerëzore/humane, RSSS rekomandon zhvillim gradual të kapaciteteve.

Kosova është shtet i pavarur, dhe si e tillë, është përgjegjëse për sigurinë e qytetarëve dhe territorit të saj. Prandaj forca e ardhshme do të merr gradualisht përgjegjësi për mbrojtjen e vendit. Për më tepër, do të vazhdojë të merr pjesë në operacione të reagimit ndaj krizave, duke përfshirë dhe operacione të mbështetjes së paqes; të ndihmojë autoritetet civile në reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave, përshirë këtu edhe gatishmërinë për reagim në nivel rajonal dhe atë ndërkombëtar; të bëjë asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer; dhe t'u ndihmojë autoriteteve civile në detyrat e operacioneve të mbrojtjes civile.

Për të pasqyruar evoluimin e FSK-së, për të kryer rolet e saja të reja në të ardhmen, forca e ardhshme do të quhet Forcat e Armatosura të Kosovës. Forcat e Armatosura të Kosovës do të

jetë forcë kombëtare ushtarake që pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës, e pajisur për të përmbushur misionin e mbrojtjes, e autorizuar që të shërbejë në vend dhe jashtë vendit në mbështetje të operacioneve paqësore. Forcat e Armatosura të Kosovës do të jetë forca profesionale, që i nënshtrohet kontrollit civil demokratik, sundimit të ligjit dhe obligimeve ndërkombëtare. Si forcë e tillë, do t'i mbështesë komunitetet lokale dhe do të jetë forcë për të mirë brenda Republikës së Kosovës dhe në rajon. Forcat e Armatosura të Kosovës do të përbëhen nga komponentët aktiv dhe rezervë, vullnetarë nga të gjitha komunitete dhe do të ndërtohen sipas standardeve NATO-s për ndërveprim. Forcat e Armatosura të Kosovës do ta kenë synim të qartë pjesëmarrjen eventuale në operacione ndërkombëtare, si pjesë e strategjisë kombëtare për të ndërtuar raporte më të ngushta me NATO-në dhe përfundimisht anëtarësimin e Republikës së Kosovës në NATO.

Njëkohësisht, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të riemërohet Ministria e Mbrojtjes. Ky institucion do të udhëhiqet nga personi civil, Ministri i Mbrojtjes. Ministri i Mbrojtjes do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e Ministrisë dhe Forcave të Armatosura të Kosovës. Ministri i Mbrojtjes do të formulojë, zbatojë, vlerësojë dhe zhvillojë politikat e mbrojtjes.

Analiza. Procesi i RSSS-së përfshinë analizën gjithëpërfshirëse të mjedisit të sigurisë, identifikimin e rolit dhe misionit të Forcave të Armatosura të Kosovës, analizën e kapaciteteve të nevojshme për ta përmbushur atë rol dhe mision në të ardhmen, si dhe analizën e zbrazëtirave në mes të aftësive (kapaciteteve) ekzistuese dhe atyre të nevojshme. Bazuar në këto analiza është përcaktuar që Forcat e Armatosura të Kosovës do të marrin gradualisht përsipër, përgjegjësinë kryesore për mbrojtjen e vendit; dhe gradualisht do të transferojnë kapacitetet për të reaguar në emergjencë civile tek Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Për më shumë, është përcaktuar që Forcat e Armatosura të Kosovës të vazhdojnë të marrin pjesë në operacione të reagimit ndaj krizave, përfshirë dhe operacione të mbështetjes së paqes; mbështetjen e autoriteteve civile në reagim ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave, përfshirë këtu dhe gatishmërinë në reagim në nivel rajonal dhe ndërkombëtar; asgjësimin e mjeteve të pashpërthyer dhe asistimin e autoriteteve civile në detyra të operacioneve të mbrojtjes civile. Si rezultat, MFSK-ja i ka identifikuar parimet që do të udhëheqin zhvillimin e forcës në të ardhmen



dhe e ka krijuar planin për krijimin e kapaciteteve të nevojshme për të përmbushur misionin e saj.

### *Parime*

Forcat e Armatosura të Kosovës do të zhvillohet bazuar në parimet si në vijim:

- Forcë e përqendruar në mbrojtje të vendit;
- Forcë për të mirë e cila do të shërbejë si model i përkushtimit vullnetar ndaj vendit;
- Forcë e cila i nënshtrohet kontrollit civil demokratik;
- Forcë e cila u përgjigjet zyrtarëve të zgjedhur në mënyrë demokratike;
- Forcë vullnetare;
- Forcë profesionale;
- Forcë gjithëpërfshirëse dhe shumetnike;
- Forcë e ndërtuar sipas standardeve ndërkombëtare.

### *Plani i Zhvillimit të Forcës*

Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës me këtë madhësi, e cila është e qëndrueshme, e përballueshme dhe e aftë për të kryer detyrat e reja do të merr kohë dhe zhvillimi i saj do të jetë i ndarë në faza. Si rezultat, MFSK-së i është dashur të shikoj përtej kohës së paraparë në RSSS. Forcat e Armatosura të Kosovës do të përbëhen nga më së shumti pesë mijë [5,000] pjesëtarë të personelit aktiv; dhe më së shumti tre mijë [3,000] pjesëtarë të personelit rezervë, dhe zhvillimi i kësaj force do të bëhet përmes një procesi transparent dhe të paraparë të ndodhë në tri faza:

#### **Faza I: 2014-2016**

Në Fazën I, analiza parasheh zhvillimin dhe kompletimin e kornizës kushtetuese ligjore, doktrinave dhe koncepteve për forcën e re. Kjo fazë do të përqendrohet në trajnimin; zhvillimin e doktrinës operacionale dhe taktike; profesionalizimin, ndërtimin institucional, plotësimin e personelit dhe ndërkohë blerjen e pajisjeve. Të gjitha këto veprime me fokus primar të mbrojtjes së vendit.

Roli dhe misioni për reagim ndaj emergjencave në nivel kombëtar do të vazhdojë të zhvillohet dhe mbahet nga FSK-ja deri në transferimin tek institucionet e tjera përkatëse që janë të përcaktuara në Arkitekturën e Sigurisë (e cila mund të mos kompletohet deri tek faza II).

Kjo fazë po ashtu parasheh që forcat tona të vazhdojnë ta rrisin bashkëpunimin me shtete aleate me qëllim që të trajnohen dhe fitojnë shkathtësi për të marrë pjesë eventualisht, në mënyrë efektive, në operacione të përbashkëta, të përshtatshme, me partnerët në nivel rajonal, dhe në nivel ndërkombëtar siç janë NATO, BE, OKB, OSBE.

### **Faza II: 2017-2019**

Faza II vendos theks të veçantë në zhvillimin dhe modernizimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; blerjen e pajisjeve esenciale të nevojshme individuale dhe kolektive; dhe fillimin e krijimit të shkathtësive shtesë dhe kapaciteteve operacionale të nevojshme për forcë të re për ta mbështetur misionin kushtetues. Disa shkathtësi të arritura po ashtu mund t'i nënshtrohen ngritjes dhe përsosjes së mëtutjeshme dhe kjo i referohet në veçanti kapaciteteve nën mandatin momental, dhe nevojën për te vazhduar zhvillimin e tyre.

### **Faza III: 2020-2024**

Faza III do të shënojë fundin e përpjekjeve për zhvillimin e forcës sonë. Gjatë Fazës III secila nga komandat kryesore do të arrijnë plotësimin e tërësishëm të personelit dhe pajisjeve të saja. Për më shumë, komandat kryesore do të arrijnë kompetenca në misionet e tyre të caktuara dhe kështu do ta përmbushin planin afatgjatë të zhvillimit.

### **Rekomandimet**

- Ndryshimi i emrit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës.
- Ndryshimi i emrit nga Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në Ministria e Mbrojtjes së Kosovës.
- Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës me mision primar të mbrojtjes së vendit

- Misioni i Forcave të Armatosura të Kosovës është që të jetë gjithmonë e gatshme dhe e aftë për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin territorial, për t'i mbrojtur qytetarët, pronën e tyre dhe interesat e Republikës së Kosovës si dhe të kontribuojë në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe atij global.
- Detyrat kryesore të Forcave të Armatosura të Kosovës janë:
  - Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial;
  - Mbështetja e autoriteteve civile;
  - Mbështetja e komuniteteve;
  - Pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare në mbështetje të paqes;
- Zhvillimi i Forcave të Armatosura të Kosovës me strukturën e gjerë si në vijim: Forcat Tokësore, Garda Kombëtare, Komanda e Logjistikës dhe Komanda e Trajnimeve dhe Doktrinës.
- Zhvillimi e Forcave të Armatosura të Kosovës në tri faza:
  - Faza I (2014-2016) Zhvillimi i kornizës së nevojshme kushtetuese ligjore, institucionale dhe doktrinare për forcë të re. Fokusimi do të jetë në plotësimin me personel, doktrina, trajnime dhe infrastrukturë.
  - Faza II (2017- 2019) Theksi i veçantë vendoset në zhvillimin e kapaciteteve të komandës, kontrollit dhe komunikimit; prokurimi i armatimit dhe pajisjeve esenciale; dhe krijimi i shkathtësive shtesë dhe i kapaciteteve operacionale.
  - Faza III (2010-2024) Kompletimi i rekrutimit të personelit, të trajnimeve dhe pajisjeve për forcën në përmbushje të misionit të saj të ri të mbrojtjes së vendit.
- Të sigurohen 5 milionë euro shtesë për buxhetin e MFSK-së secilin vit deri në vitin 2019, përveç ngritjes tanimë të planifikuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
- Rishikimi i Kushtetutës dhe legjislacionit përkatës për MFSK-në dhe FSK-në, për të reflektuar emrin, misionin dhe detyrat e reja të forcës dhe ministrisë së ardhshme.
- Të kërkohet themelimi i një kurrikule në lëndën e mbrojtjes dhe të sigurisë në Universitetin e Prishtinës, me qëllim që t'ju ofrojë civilëve dhe të gjithë atyre që janë të interesuar t'i bashkohen ushtrisë, me arsimimin e duhur për t'iu bashkangjitur Forcave të Armatosura të Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

#### **7.1.4. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë saj. Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) përmbush misionin dhe objektivat strategjike në bazë të këtij legjislacioni: Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë; Ligji Nr. 04/L216; për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit; Ligji Nr. 04/L-072 për kontrollin e kufirit shtetëror; Ligji Nr. 04/L-027 për mbrojtjen kundër katastrofave natyrore dhe katastrofave të tjera; Ligji Nr. 04/L-219 për të huajt; Ligji Nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me persona dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit; Ligji Nr. 03/L-143 për armët; Ligji Nr. 04/L-217 për azilin; Ligji Nr. 04/L-215 për shtetësinë e Kosovës; Ligji Nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil; Ligji Nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri; Ligji Nr. 04/L-003 për gjendjen civile; Ligji Nr. 04/L-064 Agjencinë e Kosovës për Forensikë; Ligji Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike; Ligji Nr. 04/L-022 për përdorim civil të eksplozivëve; Ligji Nr. 04/L-004 për shërbimet private të sigurisë; Ligji Nr. 04/L-049 për zjarrëfikje dhe shpëtim, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës; Ligji Nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri; Ligji nr. 03/L-208 për ripranim; Ligji Nr. 03/L-142 për rendin dhe qetësin publike; Ligji Nr. 03/L-118 për tubimet publike; Ligji Nr. 03/L-099 për letërnjoftimin; Ligji Nr. 03/L-051 për aviacionin civil; Ligji Nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit; Ligji Nr. 02/L-118 për emrin personal, etj.

Roli dhe misioni i tanishëm. MPB mban përgjegjësinë kryesore në fushën e punëve të brendshme. Roli dhe misioni i saj kryhet përmes organeve të pavarura të MPB-së si Policia e Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Inspektorati Policor i Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia Shtetërore e Forensikës, dhe Agjencia e Regjistrimit Civil. Ministria Punëve të Brendshme kujdeset për sundimin e ligjit dhe sigurinë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në veçanti roli parësor i MPB-së është ruajtja e rendit kushtetues, mbrojtja e jetës, mirëqenies së qytetarëve dhe sigurisë të secilit individë duke garantuar të drejtat e tyre themelore. MPB në përmbushjen e detyrave kushtetuese koordinon aktivitetet e saj me institucione të tjera të Kosovës. Për më tepër, MPB mbështet institucionet tjera në sigurimin e pavarësisë së vendit, garantimin e sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial. Për realizimin e detyrave të saj me përpikëri dhe të bazuara në interesat kombëtare, MPB është aktivisht e angazhuar në promovimin e stabilitetit rajonal dhe anëtarësimin në organizatat

ndërkombëtare, posaçërisht në përfaqësimin e saj në nismat dhe institucionet e sigurisë. MPB është e angazhuar aktivisht në krijimin e një infrastrukture të duhur ligjore në fushën e punëve të brendshme, zbatimin e drejt të ligjit, kujdeset për mbrojtjen e jetës dhe pronës dhe garanton lirinë e lëvizjes për qytetarët e Kosovës. MPB është e përkushtuar të parandaloj dhe reduktoj krimin në përgjithësi dhe krimin e organizuar, korrupsionin e terrorizmin në veçanti, dhe të garantoj rendin dhe sigurinë publike.

MPB ka rol të rëndësishëm në përkrahjen e mbrojtjes së integritetit territorial dhe sovranitetit. Ky tipar i MPB-së është i natyrës mbështetëse dhe përmbushet përmes agjencive të saj sikurse Policia e Kosovës. MPB në këtë fushë krahas me institucionet tjera përkatëse ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e kufirit, në veçanti roli i saj përfshinë koordinimin e aktiviteteve ndërmjet agjencive të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit. MPB ka një rol të rëndësishëm mbështetës në sigurinë e aviacionit civil. MPB aktualisht koordinon aktivitetet dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet ndërkombëtare/ misionet civile dhe ushtarake që janë të vendosura në Kosovë, posaçërisht është me rëndësi bashkëpunimi me EULEX-in në fushën e sundimit të ligjit dhe menaxhimit të kufirit. Për më tepër, MPB ka një rol të rëndësishëm mbështetës në një grup qeveritar për definimin e çështjeve të kufirit dhe shënimit të kufirit.

MPB ka rol udhëheqës në grumbullimin, analizimin dhe përshkrimin e kërcënimeve të brendshme kriminale ndaj sigurisë së Kosovës, kërcënime të atilla që rrjedhin nga aktivitetet kriminale, sikurse krimet ordinere, krimi i organizuar, korrupsioni dhe krimet financiare. Në këtë fushë MPB zhvillon politika dhe koordinon aktivitetet me institucione të tjera vendore dhe ndërkombëtare për t'i bërë ballë në mënyrë të suksesshme këtyre kërcënimeve. Gjithashtu, MPB ka rol mbështetës në grumbullimin dhe analizimin e informatave për parandalimin e aktiviteteve të spiunimit, revoltës së brendshme dhe ekstremizmit e terrorizmit.

Gjithashtu MPB mban rol udhëheqës në menaxhimin e katastrofave natyrore: ky mision kryesisht kryhet nga AME. AME ka rol udhëheqës në misionin lidhur me operacionet për të ndihmuar në katastrofat ndërkombëtare, ndërsa institucionet tjera kanë pasur rol mbështetës siç përcaktohet me legjislacionin e tanishëm dhe dokumentet strategjike sikurse Plani kombëtar i Reagimit dhe Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave. Përveç kësaj, AME është gjithashtu pjesë e grupit koordinues Evropian për Mbrojtje Civile.

*Roli dhe misioni në të ardhmen.* Roli dhe Misioni i MPB-së në fushat primare do të jetë i njëjtë në vitin 2018 sikurse në vitin 2014. MPB do të angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e sigurisë, kryesisht në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit, menaxhimit të sigurisë publike, menaxhimit të kufirit shtetëror, menaxhimit të emergjencave. Në këtë mënyrë, MPB do të vazhdoj të ketë rol mbështetës në sigurimin e pavarësisë së vendit, garantimit të sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial. MPB do të shtojë bashkëpunimin ndërkombëtare dhe do të emëroj e vendos zyrtarë ndërlidhës policor në katër vende anëtare të BE-së dhe Turqi, për të fuqizuar bashkëpunimin në fushën e policisë në luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit ilegal. MPB/AME në të ardhmen do të kenë mundësi të reagojnë në katastrofa rajonale të shkaktuara nga natyra ose njeriu, dhe do të ndërmarr nisma për anëtarësimin e agjencive të saj në institucione ndërkombëtare të natyrës së reagimit ndaj katastrofave.

Gjithashtu, MPB në të ardhmen do të ketë rol udhëheqës në menaxhimin dhe trajtimin e të gjitha rasteve që rezultojnë nga aktet terroriste. MPB/PK do të koordinoj të gjitha aktivitetet me institucionet tjera mbështetëse. Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të cilat janë pjesë e këtij misioni duhet të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në Planin e Reagimit Kombëtar, si dhe në Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave. MPB do të ketë rol udhëheqës në menaxhimin e katastrofave. Ky mision do të realizohet nga AME si agjenci e specializuar. AME do të ketë rol kryesorë udhëheqës dhe përgjegjësi koordinuese në këtë fushë. AME gjithashtu ka rol udhëheqës në menaxhimin e katastrofave ndërkombëtare, ndërsa institucionet tjera do të kenë rol mbështetës.

Analiza. Sa i përket marrëdhënieve me misionet ndërkombëtare si KFOR dhe EULEX, MPB do të mbaj dhe zhvillojë marrëdhënie të tilla varësisht prej mandatit që ato do të kenë në të ardhmen. Periudha e ardhshme për MPB-në do të shënohet me shtimin e gatishmërisë për kompetenca shtesë varësisht nga situata dhe mjedisi.

Gjatë periudhës 2014-2018, Policia e Kosovës duhet të zhvilloj më tutje kapacitetet për menaxhimin e incidenteve të mëdha, posaçërisht Policia e Kosovës duhet të pajiset me mjete të përshtatshme (makina të blinduara). Këto incidente përfshijnë protesta, turma të dhunshme dhe trazira dhe incidente të tjera me shkallë të lartë të dhunës.

Megjithëse MPB sipas legjislacionit gjithmonë kishte rol parësor për reagim ndaj katastrofave, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave nuk është përkrahur asnjëherë për të përmbushur këtë mision. Mirëpo në anën tjetër, FSK ka luajtur *de facto* rol parësor reagues për shumë emergjenca vendore. Prandaj, në periudhën ndërmjet viteve 2014 dhe 2018, MPB do të përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve të AME-së (burime njerëzore, trajnime, logjistik) në mënyrë që të përmbush rolin kryesor të saj në menaxhimin e incidenteve dhe katastrofave natyrore.

Ndërmjet periudhës 2014 dhe 2018, MPB do të shtoj kapacitetet dhe aftësitë e AME-së në mënyrë që të funksionoj si institucion udhëheqës për menaxhimin e materialeve të rrezikshme, i cili aktualisht është një funksion i kryer nga FSK. Përveç kësaj në fushën më specifike të rreziqeve radiologjike, Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Nukleare - AKMRSN (një agjencia aktualisht në kuadër të Zyrës së Kryeministrit) që merret me politika dhe çështje rregullative do të kalohet në kuadër të MPB-së dhe të marr përsipër rol më të gjerë në rregullimin dhe monitorimin e materialeve të rrezikshme.

Plani Kombëtar për Reagim dhe Sistemi i Integruar për Menaxhimin e Emergjencave duhet të rishikohet dhe harmonizohet me nevojat, kërkesat dhe arkitekturën e ardhshme të sektorit të sigurisë.

Në bazë të dokumenteve strategjike – Planit Kombëtar për Reagim dhe Sistemit të Integruar për Menaxhim të Integruar – parashikohet që në kuadër të MPB-së të krijohet një Qendër Operative e cila do të shërbejë për menaxhim dhe koordinim të situatave. Përveç kësaj, në kuadër të MPB-së do të vazhdojnë të funksionojnë të gjitha strukturat raportuese, si qendrat raportuese/operacionale në kuadër të KP-së, sistemi paralajmërues dhe alarmues i emergjencave 112 në kuadër të AME-së, dhe Qendra Operative për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

### Rekomandimet për MPB

- Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive të Policisë së Kosovës në fushën e menaxhimit të incidenteve serioze/madhore, sikurse kontrolli i turmave dhe trazirave – (makina të blinduara përfshirë mirëmbajtjen, burimet njerëzore, trajnimet dhe nevoja të tjera mbështetëse) të nevojshme për menaxhimin e incidenteve të tilla (kjo do të kushtoj 1,500,000.0 Euro gjatë periudhës 2014-2018)

- Hartimi i ligjit për Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave për shtimin e kapaciteteve në këtë agjenci, në mënyrë që të përmbush misionin kryesor të saj në menaxhimin e incidenteve dhe katastrofave natyrore;
- Gradualisht të vazhdohet marrja e përgjegjësive për menaxhimin dhe kontrollin e vijës së gjelbër të kufirit, e cila nuk është transferuar ende tek Policia e Kosovës. Marrja e këtyre përgjegjësive kërkon ngritje të kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Kostoja e projektuar për ngritjen e kapaciteteve për këtë projekt është planifikuar dhe përfshirë në buxhetin aktual;
- Rishikimi i Planit të Reagimit Kombëtar dhe Sistemit të Integruar për Menaxhimin e Emergjencave për tu harmonizuar me nevojat, kërkesat dhe arkitekturën e ardhshme të sektorit të sigurisë;
- Krijimi i një Qendre Operative në kuadër të MPB-së e cila do të shërbejë për menaxhimin dhe koordinimin e situatave emergjente, dhe mund të ketë një rol të rëndësishëm në lidhje me raportimin (kjo do të kushtoj 225.000,0 Euro gjatë periudhës 2014-2018);
- MPB/AME të marrin rolin udhëheqës në reagimin ndaj emergjencave dhe të mbështeten nga institucione të tjera (posaçërisht në koordinim me FAK). Për ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen për zbatimin e rolit dhe funksioneve, AME do të ketë nevojë për një buxhet afër 2.279.000,0 Euro;
- MPB/AME të marrin rolin udhëheqës në menaxhimin e materialeve të rrezikshme dhe të përkrahjet nga institucionet tjera. Buxheti i nevojshëm gjatë periudhës 2014-2018 për këtë është 890.000,0 Euro, që përfshinë personelin, pajisjet, makinat, laboratorin, hapësirat dhe trajnimet;
- Ngritja e kapaciteteve të njësisë së helikopterëve në mënyrë që të përmbush aktivitetet dhe misionin në fushën e rendit dhe sigurisë publike, kontrollit të kufirit, menaxhimit të emergjencave, operacione speciale dhe përkrahje të institucioneve të tjera si transportim dhe mbështetje mjekësore (Ky projekt do të kushtoj në vitin e parë = 10.590.715,00 Euro, vitin e dytë = 15.592.830,00 Euro dhe vitin e tretë = 9.972.830,00 Euro, në total = 36.156.375,00 Euro).



### **7.1.5. Ministria e Drejtësisë (MD)**

Baza ligjore për funksionet dhe përgjegjësitë e saj. Baza ligjore për funksionet dhe përgjegjësitë e MD për përmbushjen e rolit dhe misionit është e bazuar në këto ligje: Neni 93 i Kushtetutës; Rregullorja e Qeverisë Nr. 02/2011 për përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë dhe dispozitat ligjore; Kodi Penal i Kosovës; Kodi i Procedurës Penale të Kosovës; Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale; Ligji për mjekësinë ligjore; Ligji për mbrojtjen e viktimave; Ligji për Konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale (ligji kundër mafi); Ligji për përgjegjësitë e personave juridik; Ligji për bashkëpunim juridik në çështje penale; Ligji për Gjykatat; Ligji për Prokurorinë.

Roli dhe misioni i tanishëm. Roli dhe misioni i MD-së që nga themelimi ka qenë:

- Zhvillon politikën brenda fushës së saj të përgjegjësisë, mundëson përgatitjen dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e drejtësisë;
- Menaxhon çështjet administrative, financiare dhe buxhetore të Ministrisë;
- Ushtron mbikëqyrje ekzekutive mbi tërë shërbimin korrektues dhe shërbimin sprovues, në pajtim me dispozitat në fuqi;
- Zhvillon dhe zbaton politika për të siguruar qasje të drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve në pajtim me ligjin në fuqi;
- Ushtron përgjegjësitë në kërkimin, marrjen, sigurimin dhe verifikimin e informacioneve lidhur me vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur dhe kthimin e eshtrave të personave të zhdukur, shfrytëzimin e ndihmës dhe të ekspertizës së personelit përkatës, si dhe të specialistëve të tjerë, në pajtim me dispozitat në fuqi;
- Ushtron përgjegjësitë për çështjet që kanë të bëjnë me mjekësinë ligjore dhe hulumtimin e krimeve të luftës në pajtim me dispozitat në fuqi;
- Ofron ndihmë juridike ndërkombëtare;
- Përfaqëson autoritetet publike në procedurat gjyqësore dhe të arbitrazhit;
- Ofron mbështetje me ekspertë në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Mbikëqyr sistemin e noterisë, ndërmjetësimin dhe provimin e jurisprudencës;

- Ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Kryen edhe detyra të tjera, që i caktohen Ministrisë me legjislacionin përkatës në fuqi.

*Roli dhe misioni në të ardhmen.* Roli dhe misioni i MD-së nuk do të ndryshoj në periudhën 2014-2018. Përgjegjësitë, funksionet dhe sfidat e MD-së do të vazhdojnë të fokusohen në mbështetje të zhvillimeve të tjera politike që priten të ndodhin me anëtarësimin e plotë të Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare. Kjo do të promovoj stabilitetin dhe sigurinë rajonale. Gjithashtu, marrëdhëniet me praninë e mbetur ndërkombëtare (EULEX) dhe përkrahja për ngritje të kapaciteteve (organet qendrore shtetërore) do të mbesin një aspekt i rëndësishëm i punës në fushën e drejtësisë. MD dhe Qeveria riafirmojnë përkushtimin e tyre për të punuar ngushtë me EULEX-in dhe misione/organizata të tjera ndërkombëtare që punojnë në fushën e drejtësisë dhe sigurisë. Për më tepër, MD shpreh vullnetin dhe gatishmërinë për të marr përgjegjësi të reja të parashikuara me ligj dhe të cilat do të rrjedhin nga procesi i dialogut për normalizim me Serbinë.

*Analiza.* Aktualisht EULEX-i luan një rol të rëndësishëm në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin në sektorin e drejtësisë. Periudha 2014-2018 do të shënohet me procesin e transferimit gradual të kompetencave nga EULEX-i tek institucionet vendore. Megjithatë, MD njeh faktin se ekziston nevoja për përkrahjen e vazhdueshme ndërkombëtare kryesisht përmes mentorimit, monitorimit dhe këshillimit dhe ofrimit të ekspertizës duke synuar fuqizimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të institucioneve vendore.

*Gjykatat dhe Prokuroria:* Në pajtim me praktikën më të mira të njohura dhe procesin për Reformën e Drejtësisë, MD do të kujdeset për hartimin e ligjeve në fushën e Gjyqësorit në pajtueshmëri me standardet e BE-së dhe do të përkrah zbatimin e këtyre ligjeve dhe shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nevojës dhe specifikat e situatës. Obligimet që rezultojnë nga dialogu me Serbinë janë marrë parasysh plotësisht nga ana e MD-së dhe deri më tani MD ka ndërmarr të gjitha masat e kërkuara për të përmbushur këto obligime, duke synuar integrimin dhe funksionalizimin e Gjykatave dhe Prokurorisë që janë në veri nën juridiksionin e plotë të Kosovës dhe nën legjislacionin e Kosovës. MD synon të krijoj një sistem të drejtësisë plotësisht funksional, që do të mund të përfshijë funksionimin e gjykatave dhe agjencive të

zbatimit të ligjit në Mitrovicën e Veriut, Zvecan, Zubin Potok dhe Leposaviq nën ombrellën e institucioneve të Kosovës dhe në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.

*Shërbimet Korrektuese:* Është ende e nevojshme të shtohet efikasiteti i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës, duke shtuar disiplinën në punë si dhe respektimin e të drejtave të të burgosurve. Për të mbështetur këto përpjekje, MD ka themeluar një Departament për Inspeksion. Ky Departament ka katër inspektor, i cili nuk është i mjaftueshëm të kryej misionin e tij. Nga periudha 2014-2018 ndërtimi i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan dhe Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë gjithashtu do të shtojë kapacitetet e shërbimit korrektues (buxheti për këto projekte është mbuluar nga Ministria e Administratës Publike). Pajisjet e përshtatshme për kontrollimin e trazirave janë gjithashtu të nevojshme për burgjet; në periudhën 2014-2018 Ministria e Drejtësisë do të punoj me OSBE-në për blerjen/prokurimin e këtyre pajisjeve. Në përgjithësi, këshillimi dhe mentorimi i vazhdueshëm do të ishte i nevojshëm në fushën e shërbimeve korrektuese.

MD do të vazhdoj të zhvilloj plane trajnuese në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri dhe sipas nevojës do të plotësoj dhe ndryshoj trajnimet duke filluar nga ato themelore deri në ato më të avancuara në bashkëpunim me PK-në dhe ekspertët e EULEX-it.

*Mjekësia Ligjore:* MD do të vazhdojë të përmirësoj kapacitetet e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit në bashkëpunim me Komisionin Qeveritar për Personat e Pagjetur (me fokus në identifikimin e mbetjeve mortore). Në fushën e mjekësisë ligjore, MD gjithashtu beson se mentorimi dhe këshillimi i vazhdueshëm nga organet përkatëse ndërkombëtare posaçërisht në formë të ekspertizës do të ishte ende i nevojshëm. MD do të vazhdoj të zhvilloj plane trajnuese në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtrri dhe sipas nevojës do të plotësoj dhe ndryshoj trajnimet duke filluar nga ato themeloret deri në ato më të avancuarat në bashkëpunim me ekspertët e PK-së dhe EULEX-it.

#### Rekomandimet për MD

- Departamenti i Inspeksionit të plotësohet me gjashtë inspektor shtesë (kjo do të kushtoj 180.000 Euro gjatë periudhës 2014-2018);

- Të shtohet numri i gjykatësve dhe prokurorëve (implikimet buxhetore do të shqyrtohen në bazë të nevojës);
- Të ngritët bashkëpunimi ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit në Kosovë me synim të sigurimit të një sistemi gjyqësor më efikas.

#### **7.1.6. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është themeluar në bazë të nenit 129 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Roli dhe misioni i tanishëm. Roli i AKI-së është përmbushja e nevojave të Republikës së Kosovës në aspektin e sigurimit të informatave të sakta dhe me kohë të inteligjencës, kundër inteligjencës, kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme, terrorizmit të brendshëm dhe ndërkombëtar, përpunimit të narkotikëve, krimit të organizuar, krimeve ekonomike, sabotazhit, dhe çështje të tjera të inteligjencës lidhur me sigurinë e Kosovës. Për përmbushjen objektivave të saj, AKI mbledh, analizon dhe shpërndan informata në mënyrë të shpejtë dhe të përgjegjshme lidhur me kërcënimet kundër Kosovës, duke përfshirë: kërcënimet kundër integritetit territorial, integritetit institucional, rendit kushtetues, zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit dhe kërcënimeve globale që dëmtojnë Republikën e Kosovës. Mandati i AKI-së është që të funksionoj përgjatë tërë territorit të Republikës së Kosovës dhe të mbledh informata lidhur me kërcënimet e sigurisë së Kosovës, përfshirë spiunazhin dhe nxitjen e revoltave të brendshme, ekstremizmin dhe terrorizmin. AKI gjithashtu ka përgjegjësi për të kryer procedurat e verifikimit të sigurisë lidhur me individët dhe personat juridik në kuadër të institucioneve publike dhe kontraktorëve me qasje në informata të klasifikuara në Kosovë.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Ndonëse AKI aktualisht ka kapacitete për të funksionuar në territorin e Republikës së Kosovës për përmbushjen e mandatit të saj ligjor, gjithashtu do të jetë më e përgjegjshme dhe e kujdesshme për grumbullimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave në lidhje me kërcënimet e mundshme të brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë së Republikës së Kosovës.

Analiza. Misioni i ri i AKI-së zgjeron mandatin e saj për grumbullin e informatave jo vetëm lidhur me kërcënimet e brendshme ndaj sigurisë së Kosovës por gjithashtu edhe kërcënimet e

jashtme. Për të kryer misionin dhe përgjegjësit e reja personeli i AKI-së do të ketë nevojë të ndërveproj me agjencitë simotra jashtë vendit. Struktura, personeli dhe korniza ligjore e AKI-së do të përshtaten me marrjen e detyrave të reja.

### Rekomandimet për AKI

- Sigurimi i burimeve shtesë financiare për të mundësuar trajnimet, pajisjet dhe personelin e nevojshëm për një agjenci gjithnjë e më të profesionalizuar (2 milion Euro gjatë periudhës 2014-2018).

### **7.1.7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj. Që nga themelimi i saj në vitin 2002, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) kryen misionin në bazë të legjislacionit në vijim: Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e lartë të Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 04/L –032 për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës; Ligji Nr. 2004/42 aktivitetet e hulumtimeve shkencore; Ligji Nr. 2004/37 për Inspeksionin arsimor në Kosovë; Ligji Nr. 04/L-138 për arsimin dhe trajnimin profesional; Ligji Nr. 02/L-24 për arsimin dhe aftësimin e të rriturve; Ligji Nr. 02/L-52 për arsimin parashkollor; Ligji Nr. 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumenteve pedagogjike; Ligji Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës; Ligji Nr. 03/L-018 për provimin përfundimtar dhe provimin shtetëror të maturës; Ligji Nr. 03/L-060 për kualifikimet kombëtare.

Roli dhe misioni i tanishëm. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (prill 2008) dhe ligjet tjera të aplikueshme garantojnë të drejtën për arsimim, ku institucionet publike sigurojnë mundësi të barabarta për secilin në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre. Imperativi i zhvillimit ekonomik është që të garantoj qasje universale dhe ku të varfëritë dhe grupet e cënueshme dhe popullata etnike të kenë qasje në arsimin themelor, si rrjedhojë përkrahen mundësitë për punësim dhe pjesëmarrje në aktivitete ekonomike. MASHT ka bërë përpjekje të shkëlqyeshme për të krijuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe t'i ofroj të gjithë qytetarëve në Republikën e Kosovës qasje të barabartë në arsim cilësor të të gjitha niveleve; një sistem që i pajis të gjithë qytetarët e Kosovës me shkathtësi të përjetshme për njohuri të avancuara të integruar në shoqërinë

Evropiane dhe të kontribuoj në zhvillimin afatgjatë të qëndrueshëm ekonomik të vendit përmes krijimit të vendeve të punës dhe zgjerimit të kohezionit social.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Roli dhe misioni i MASHT-it nuk do të ndryshojë në periudhën 2014 -2018.

Analiza. Gjatë periudhës 2014-2018, MASHT-i synon të fuqizoj arsimin për qytetarët e Kosovës, me fokus të veçantë në:

- Lehtësimin dhe promovimin e zhvillimit të plotë të secilit individë;
- Zhvillimin dhe inkurajimin e sistemit arsimor që përmbush nevojat e Kosovës dhe qytetarëve të saj përmes të mësuarit gjatë tërë jetës;
- Krijimin, ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve dhe ndërlidhjes të të gjitha niveleve të arsimit në Kosovë me standardet Evropiane;
- Të përfuturuarit nga të gjitha nivelet e mundshme të arsimit sa më gjerë që është e mundur për të gjithë qytetarët e Kosovës;
- Promovimin e shkencës dhe teknologjisë për një shoqëri moderne me fokus të veçantë në teknologjinë informative dhe të komunikimit – ICT;
- Promovimin e gjithëpërfshirjes në arsim dhe trajnim që është i mundur për të gjithë personat e përjashtuar nga shoqëria, personat e varfër, personat me aftësi të kufizuara, si dhe për ata të cilët janë të pafavorizuar dhe marginalizuar në aspektin arsimor dhe përmirësimi i mundësive për femrat dhe vajzat;
- Promovimin e përfshirjes sociale si një koncept gjithëpërfshirës që bënë të mundur pjesëmarrjen e plotë të të gjithë qytetarëve në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore, pavarësisht dallimeve sociale (si gjinia, përkatësia etnike, klasa sociale dhe paaftësitë);
- Sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë të njerëzve në vendimmarrje që ndikon në jetën e tyre dhe qasje në të drejtat e tyre themelore.

#### Rekomandimet për MASHT

- Sipas RSSS, është e qartë se Republika e Kosovës kërkohet të përgatitë profesionist të trajnuar dhe arsimuar në studime të sigurisë për të përmbushur pozitën në institucionet e sigurisë. Rekomandohet që Universiteti i Prishtinës të zhvillojë një kurikul për fushën e

mbrojtjes dhe sigurisë për adresimin e arsimit dhe trajnimit të studentëve universitar në mënyrë që të ndihmoj në zhvillimin e liderëve të ardhshëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës.

#### **7.1.8. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj. Që nga themelimi në vitin 2002, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) misionin e saj e kryen në bazë të legjislacionit në vijim: Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e Mjedisit; Ligji për mbrojtjen e natyrës; Ligji Nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor; Ligji Nr. 03/L-104 për sigurinë nukleare; Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja; Ligji Nr. 04/ L-147 për ujërat e Kosovës; Ligji Nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor; Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtimet; Ligji Nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura.

Roli dhe misioni i tanishëm. MMPH është përgjegjëse për rregullimin dhe menaxhimin e mjedisi dhe koordinimin e zhvillimit hapësinor. MMPH më saktësisht është e mandatar për zhvillimin dhe monitorimin e politikave, normave dhe standardeve si dhe koordinimin e aktiviteteve të mbrojtjes së mjedisit, monitorimit të ajrit, menaxhimit të ujërave, zhvillimit të banimit dhe ndërtimit, shpronësimit, kadastrës dhe planifikimit hapësinor. Konkretisht MMPH është përgjegjëse për:

- Mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimit racional të burimeve natyrore;
- Monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore;
- Menaxhimin efikas të mbeturinave;
- Menaxhimin e integruar të ujërave;
- Zhvillimin dhe koordinimin e qëndrueshëm hapësinor;
- Përmirësimin e standardeve të jetesës dhe cilësisë së jetës;
- Zhvillimin e ndërtimit të sigurt dhe të qëndrueshëm;
- Zhvillimin dhe promovimin e politikave dhe strategjive në fushën e kadastrës;
- Monitorimin e ndikimit potencial të ndryshimeve klimatike;
- Inspektimin dhe zbatimin e ligjit në kuadër të mandatit të MMPH-së;

- Pjesëmarrje aktive dhe bashkëpunim në nismat Evropiane dhe ndërkombëtare për sektorin e mjedisit.

Roli dhe Misioni në të ardhmen. Roli dhe Misioni i MMPH-së nuk do të ndryshoj gjatë periudhës 2014-2018.

Analiza. MMPH do të vazhdoj përmbushjen e mandatit të saj për rregullimin dhe menaxhimin e mjedisit dhe koordinimin e zhvillimi hapësinor. MMPH do të fuqizoj zbatimin e të gjitha ligjeve, politikave dhe standardeve. MMPH dhe njësitë e saj të specializuara gjithashtu janë përgjegjëse për ofrimin informatave të plota lidhur me lokacionet e rrezikuara, duke përfshirë:

- Të dhënat hidrometeorologjike dhe parashikimet;
- Të dhëna hapësinore lidhur me lokacionin e një ngjarjeje me të gjitha të dhënat mbështetëse, përfshirë sipërfaqen, numrin e personave dhe objektet e rrezikuara, informata rreth mjedisit, llojit dhe sasinë e rrezikut të tokës; informata të hollësishme rreth ujërave dhe ndikimit të tyre dhe informata të tjera relevante.

#### Rekomandimet për MMPH

- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në sektorin e hidrometeorologjisë dhe parashikimit të motit, në mënyrë që të ofrohen parashikime të sakta të kohës dhe të bëhen paralajmërimet në kohë për të papriturat e mundshme meteorologjike (buxheti i përafërt vjetor prej 50,000 Euro për tri vite në periudhën 2014-2018).
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike në sektorin e Sistemit Informativ Gjeografik (GIS) për të ofruar të gjitha informatat e nevojshme, përfshirë të dhënat hapësinore rreth mjedisit, ujërave, banimit dhe informata të tjera të nevojshme hapësinore (buxheti i përafërt vjetor i duhur prej 50,000€ për tri vite në periudhën 2014-2018).

#### **7.1.9. Ministria e Financave (MF)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj. Ministria e Financave është e organizuar dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi, që rregullon raportet në fushën e financave, tatimeve dhe doganave. Përgjegjësitë e MF-së janë të përcaktuara nga një numër ligjesh dhe rregulloresh,



të cilat janë drejtpërdrejt të lidhur me Ministrinë e Financave dhe strukturat administrative të saj. Më të rëndësishmet janë: Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar, Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e qeverisjes lokale, Ligji Nr. 03/L-090 për Partneritetin publiko privat dhe koncesionet në infrastrukturë dhe procedurat për dhënien e tyre; Ligji Nr. 03/L-175 për borxhin publik; Ligji Nr. 03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, Ligji Nr. 2004/48 dhe ndryshimi i Ligjit 03/L-071 për Administratën tatimore dhe procedurat, Ligji Nr. 03/L-109 për Doganat dhe kodin e akcizës, i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-099, Ligji Nr. 03/L-152 për anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Bankës Botërore, Rregullorja Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë së Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2014-2016, Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Roli dhe misioni i tanishëm. Misioni i Ministrisë së Financave (MF) është ruajtja e stabilitetit makro-fiskal për qëllim të zhvillimit ekonomik. Kjo arrihet përmes zhvillimit të politikave të përgjegjshme, të drejta dhe transparente fiskale dhe buxhetore. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të shëndosha makro-ekonomike do të vazhdojë në ndërthurje me Kuvendin e Kosovës, Ministrinë, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe donatorët.

Funksionet e MF-së përfshijnë rolin e saj kyç në përcaktimin dhe zbatimin e politikave financiare të Qeverisë, duke ndërmarr veprime të përcaktuara me legjislacion, të tilla si:

- Monitorimi, analizimi dhe ofrimi i parashikimeve të zhvillimeve makroekonomike, përgatitja e dokumentit të buxhetit dhe politikave fiskale dhe financiare të qeverisë;
- Rishikimi dhe ofrimi i komenteve lidhur më aranzhimet ndërkombëtare financiare dhe aktivitete të tjera të ndërlidhura të qeverisë;
- Zhvillimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës si mjeti kryesor strategjik i qeverisë për planifikimin dhe ndarjen e burimeve, sigurimin e parashikimeve, paanësi dhe llogaridhënie në financat publike dhe përmirësimin e konsiderueshëm i cilësisë dhe produktivitetit shërbimeve të ofruara në lidhje me koston;

- Sigurimi e të ardhurat të planifikuara të qeverisë përmes zbatimit efektiv, efikas dhe transparent të sistemit, të detyrueshëm dhe zbatimit të menaxhueshëm tatimor, që është i leverdishëm për zhvillim të qëndrueshëm gjithëpërfshirës të sektorit privat;
- Aplikimi i praktikave më të mira në menaxhimin e fondeve publike. Grumbullim dhe regjistrim të rregullt, efikas dhe të saktë të të gjitha të hyrave të qeverisë dhe zotimeve të donatorëve;
- Përgatitja e rregullave të menaxhimit financiar, sistemit të kontrollit të brendshëm që përkrah dhe mundëson menaxhimin e financave në pajtim me praktikat më të mira;
- Promovimi dhe zbatimi i tatimeve të duhura, shpenzime dhe përgjegjësi të ndara ndërmjet qeverisë dhe komunave në një mënyrë financiarisht të qëndrueshme, të hapur, të drejtë dhe funksionale. Gjithashtu, në rast të katastrofave dhe emergjencave të paparashikuara një fond rezervë është i vendosur në kuadër të MF-së për financimin e shpenzimeve të emergjencës dhe shpenzimeve të paparashikuara të organizatës buxhetore. Këto fonde duhet të aplikohen dhe miratohen në mënyrë të ndarë nga ana e qeverisë.

Dogana e Kosovës. Doganat e Kosovës ka një mision të gjerë, duke filluar nga mbrojtja e shtetit, ekonomisë dhe qytetarëve. Prandaj, misioni i Doganës së Kosovës është marrja e vendimeve të duhura për të ardhurat, lehtësimi i tregtisë dhe rekrutimi i kontribuuesve të rinj tatimor duke promovuar ngritjen e vetëdijes lidhur me obligimet për t'iu bindur në mënyrë vullnetare ligjit për tatimet dhe ligjit doganor, dhe të ofroj cilësi dhe shërbime përkatëse para publikut. Ky mision si i tillë është i ndarë në dy kategori kryesore: kontributi në çështje të ekonomisë dhe kontributi në siguri. Si një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës, me mbi 60% të të ardhurave vjetore, Dogana e Kosovës është kontribuuesi kryesor i buxhetit të Kosovës. Si rezultat i pranisë së saj dhe nivelit të kontrolleve që aplikohen në pikat kufitare, Dogana e Kosovës ka rol kyç në menaxhimin e integruar të kufirit.

Njësia e Inteligjencës Financiare – NJIF. Për luftimin efektiv të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë, në kuadër të Ministrisë së Eunomisë dhe Financave është krijuar Njësia e Inteligjencës Financiare si një institucion i pavarur qendror përgjegjës për hetimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen e informatave tek autoritetet kompetente, si dhe

zbulimin e informatave lidhur me shpëlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit. Funkcionet dhe përgjegjësitë e NJIF-së janë të përcaktuara me ligj. NJIF dhe institucionet e organet tjera në Kosovë janë të obliguara të bashkëpunojnë, ndihmojnë njëra tjetrën në kryerjen e detyrave dhe koordinimin e aktiviteteve në kuadër të mandatit të tyre në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm. NJIF ka bashkëpunim të mirë me organet inteligjencës, si Agjencia e Inteligjencës dhe Policia e Kosovës.

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Misioni i ATK-së është:

- të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore;
- të ofrohen shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve;
- të sigurohet zbatim i drejt dhe i njëjlojshëm si dhe fuqizim i ligjeve tatimore me qëllim që të mblidhen të hyrat në buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me kosto të ultë.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Roli dhe misioni themelor i MF-së nuk do të ndryshoj gjatë periudhës 2014-2018.

Analiza. Procesi i integritimit Evropian do të ketë ndikim në MF në periudhën 2014-2018, ndonëse kjo nuk pritet të kërkoj ndryshime në ligjet themelore në fuqi. Disa kapacitete shtesë pritet të zhvillohen në të ardhmen, e cila do të ndikoj në zhvillimin dhe avancimin e rolit dhe përgjegjësi të MF-së. Këto përmirësime do të përfshijnë: krijimi i burimeve për funksionet e politik bërjes, zhvillimi i burimeve njerëzore në aspektin e menaxhimit administrativ dhe strategjik të tyre, reformimi i procesit buxhetor të bazuar në praktikat më të mirë dhe bashkëpunimi rajonal.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit – Negocimi i Kapitullit IV – Lëvizja e lirë e mallrave.

Qeveria e Kosovës ka filluar negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Komisionin Evropian. Në kuadër të kapitujve për tu negociuar është edhe Kapitulli IV për lëvizjen e lirë të mallrave. Ky Kapitull do të përcaktoj kohëzgjatjen për zbatim të plotë dhe tarifatat doganore ndërmjet palëve nënshkruese.

Propozimi i prezantuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë tek Komisioni Evropian, llogaritet të ketë një ndikim vjetor të humbjes të të ardhurave për buxhetin e Republikës së Kosovës në rreth 20 deri 25 milion euro.

MF do të vazhdoj të zbatoj objektivat e saj afatmesme, të cilat janë:

- Menaxhimi, planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit shtetëror në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme, kontrollin e tyre të brendshëm si dhe rritjen e kontrollit institucional të qarkullimit të parasë në vend;
- Politika të qëndrueshme me qëllim të mbajtjes së stabilitetit makroekonomik, në veçanti stabilitetit fiskal, përmes studimeve dhe vlerësimeve profesionale të të gjithë agregateve të vlefshëm për realizimin e planeve bashkëkohore të zhvillimit;
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të grumbullimit dhe administrimit të tatimeve dhe të ardhurave doganore;
- Fuqizimi i nivelit të bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare përgjegjëse në fushën financiare, dhe përmbushja e obligimeve tona në procesin e Integritetit Evropian në fushën e financave.

Doganat e Kosovës. Shumica e funksioneve të kryera nga Dogana e Kosovës do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, megjithëse kapacitete shtesë pritet të zhvillohen që do të kontribuojnë në parandalimin e aktiviteteve terroriste dhe trafikimit ilegal. Në pajtim me parimet e Kornizës së Organizatës Botërore të Doganave për Sigurinë e Zinxhirit Furnizues, Doganat e Kosovës në aspektin afatshkurtër do të fillojnë zbatimin e sistemit të Operatorëve të Autorizuar Ekonomik dhe gjithashtu, kur të mundësohet teknikisht, Doganat e Kosovës do të dërgojnë zyrtar ndërlidhës në Qendrën e Bashkëpunimi Rajonal – SELEC, ambasadat e Kosovës jashtë vendit dhe organizata tjera ndërkombëtare.

Njësia për Inteligjencë Financiare. funksionet të cilat aktualisht kryhen nga NJIF do të vazhdojnë edhe në të ardhmen pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm. NJIF pritet të bëhet anëtare e organizatave ndërkombëtare, me fokus për t'iu bashkuar grupit Egmont (Egmont Group). Do të ketë shpenzime shtesë lidhur me anëtarësimin në këtë organizatë, si tarifa vjetore e anëtarësimit. Gjatë periudhës 2014-2018 do të nevojitet personel shtesë pasi që EULEX të transferoj përgjegjësitë tek qeveria e Kosovës. Në përgjithësi, NJIF-së i duhen hapësira të përshtatshme dhe

staf profesional të duhur, si dhe fuqizim të bashkëpunimit ndërmjet agjencive. Ministria e Financave parashikon se implikimet financiare të përmirësimeve specifike në MF janë kryesisht kostot administrative, të cilat mund të sigurohen përmes ndarjeve vjetore buxhetore, të përballueshme financiarisht dhe pa ndryshime të konsiderueshme në kostot operative. Financimi i kostos për kapacitete shtesë pritet të mbulohet nga kursimet vendore dhe të përfshihet në kuadër të ndarjeve vjetore buxhetore, dhe pa asnjë impakt shtesë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### Rekomandimet për MF.

- Kur të jetë e mundur teknikisht, Doganat e Kosovës të dërgojnë zyrtarët ndërlidhës në Qendrën Rajonale Operacionale – SELEC, ambasadat e Kosovës jashtë vendit, dhe organizata të tjera ndërkombëtare (kosto administrative, me disa ndryshime të vogla në linjat aktuale buxhetore).
- Anëtarësimi i NJIF-së në Grupin Punues Rajonal të NJIF-ve në rajon për të shtuar shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe të zhvillojë parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjeve të parasë dhe konfiskimet e të ardhurave nga krimet (kjo do të kushtoj 5,000 deri 10,000 euro për periudhën 2014-2018);
- Anëtarësimi i NJIF-së në Grupin Egmont të Njësisë për Inteligjencë Financiare dhe bashkëpunimit operacional të NJIF-së me të gjitha vendet tjera duke nënshkruar Memorandume të Mirëkuptimit për ngritjen e shkëmbimit ndërkombëtarë të inteligjencës financiare (Ilogaritet të kushtoj 8,000 deri 10,000 euro për periudhën 2014-2018).
- Përmirësimi i bashkëpunimit të NJIF-së me organe të tjera të inteligjencës (kostoja është kryesisht administrative dhe e përballueshme për ndarjet e planifikuara).

#### **7.1.10. Ministria e Shëndetësisë (MSH)**

Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj. Sistemi shëndetësor funksionon në bazë të një game të gjerë të ligjeve që janë gjithëpërfshirëse: Ligji Nr. 4/2004 për shëndetësinë; Ligji Nr. 22/2003 për inspektoratin sanitar të Kosovës; Ligji Nr. 38/2004 për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor; Ligji Nr. 50/2004 për praktikumin e kujdesit shëndetësor privat; Ligji Nr. 02-L36 për duhanin; Ligji Nr. 02-L38/ për Inspektoratin shëndetësor; Ligji Nr.

02-L50 për Kujdesin shëndetësor emergjent; Ligji Nr. 02-L76 për shëndetin riprodhues; Ligji Nr. 02-L81 për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri; Ligji Nr. 02-L78 për shëndetin publik; Ligji Nr. 02-L101 për transfuzionin e gjakut; Ligji Nr. 02-L109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse; Ligji Nr. 03-L-110 për ndërprerjen e shtatëzanisë; Ligji Nr. 03-L-124 për ndryshimin e ligjit të shëndetësisë; Ligji Nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Kosovës; Ligji Nr. 03/L-188 për produktet dhe pajisjet medicinale; Ligji Nr. 04/L-156 për kontrollin e duhanit; Ligji Nr. 04/L-150 për Odat e profesionistëve shëndetësor; Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësinë. Një ligj tjetër është duket u hartuar, Ligji për sigurimet shëndetësore.

Roli dhe misioni i tanishëm. Mandati i MSH-së është zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të shëndetësisë për të ofruar shërbime cilësore të kujdesit shëndetësor për të gjithë banorët me qëllim të arritjes së standardeve Evropiane. Misioni i MSH-së është përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës me anë të nxitjes së mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe uljes së sëmundshmërisë, si dhe ofrimit të qasjes së barabartë në shërbime cilësore dhe kujdes shëndetësor efektiv, që ofrohet në tre nivele – Primar, Sekondar, dhe Terciar.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Roli dhe misioni i Ministrisë së Shëndetësisë nuk do të ndryshojë për periudhën 2014-2018.

Analiza. Politika kombëtare e MSH-së nuk është duke u zbatuar në mënyrë efektive. MSH sugjeron që Shërbimet e Mjekësore Emergjente (SHME) të organizohen si linjë e shërbimeve profesionale së bashku me shërbimet e traumatologjisë si pjesë e spitalit dhe shërbimit të klinikës Universitare të Kosovës. Zhvillimi i mëtuqjeshëm i sistemit të SHME-së në Kosovë duhet të paraqitet në një kontekst global të sistemit të gjithëmbarshtëm shëndetësor dhe kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet, përfshirë edhe programet e shëndetit publik. Kjo qasje është e nevojshme për të përmirësuar konsistencën e sistemit të SHME-së – dhe shkëmbimit të burimeve ndërmjet programeve të ndryshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe komunave (niveli primar i SHME-së në Kosovë).

Sistemi i tanishëm është pjesërisht i bazuar në nivelin komunal (Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare) dhe pjesërisht në MSH (spitalet rajonale në nivelin sekondar dhe terciar). Prandaj

sistem lokal i SHME-së, jo vetëm që duhet të jetë konsistent me prioritetet tjera të MSH-së dhe nivelin e kujdesit primar shëndetësor, por duhet të identifikoj pikat të mundshme unifikuese dhe plotësime reciproke me programet ekzistuese dhe të ardhshme të nivelit kombëtar dhe komunal. Si rrjedhojë është qenësore të zhvillohen politika kombëtare për këtë çështje dhe të identifikohen ofruesit potencial të shërbimeve të tilla nga sektori i kujdesit shëndetësor dhe sektor të tjerë në nivelin qendror dhe komunal. Zhvillimi i kapaciteteve dhe aftësive për menaxhim efektiv të situatave emergjente duke ofruar shërbime emergjente paraspitalore pashmangshmërisht do të kërkoj ngritjen e kapaciteteve të spitaleve pranuese, dhe posaçërisht menaxhimin e traumave. Në një masë të madhe spitalet do të pranojnë një numër të madh të pacientëve më poly-trauma. Prandaj, përgatitja e Politikës kombëtare për SHME duhet të merr parasysh politikën Kombëtare për menaxhimin e traumave. Një politikë e tillë duhet të përfshijë mundësitë e krijimit të një Qendre traumatike.

Ligjet ekzistuese dhe rregulloret që mbështesin zhvillimin e SHME-së duhet të rishikohen dhe përshtaten me Politikën nacionale për SHME. Është me rëndësi që të ketë një konsensus kombëtar për rolin dhe funksionet e qendrave të emergjencës 112, qendrat kryesore të mjekësisë familjare dhe modelin e SHME-së që Kosova dëshiron ta përshatë në të ardhmen. Heqja e funksionit të secilit sistem të SHME-së është një çështje e rëndësishme dhe prandaj duhet të marr vëmendjen e veçantë.

#### Rekomandimet për MSH

- Zhvillimi i një Politike Kombëtare për të identifikuar ofruesit potencial të shërbimeve të SHME-së nga sektori i shëndetësisë dhe sektor të tjerë në nivelin qendror dhe komunal;
- Përgatitja e një Politike Kombëtare për SHME që merr parasysh politikën e ardhshme Kombëtare për Menaxhim të traumave. Një politikë e tillë përfshinë mundësinë krijimit të një Qendre Emergjente Traumatike;
- Rishikimi i legjisllacionit dhe rregulloreve ekzistuese që përkrahin zhvillimin e SHME-së, dhe përshtatja e tyre me politikën Kombëtare për SHME;
- Fuqizimi i Shërbimeve Mjekësore Emergjente në periudhën deri në vitin 2018, posaçërisht në:

- Sigurimin e pajisjeve mjekësore duke përfshirë ambulancë të llojit B në të gjitha komunat e Kosovës (kjo do të kushtoj 4.900.000,00);
- Trajnimi i punëtorëve shëndetësor që punojnë në Shërbimet Mjekësore Emergjente (kjo do të kushtoj 60 000,00 Euro për periudhën 2014 - 2018);
- Integrimi i shërbimeve mjekësore emergjente në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave), duke përfshirë blerjen e pajisjeve të nevojshme për shërbimet e kujdesit primar shëndetësor.

#### **7.1.11. Ministria e Infrastrukturës (MI)**

*Baza ligjore për kompetencat dhe përgjegjësitë e saj.* Ministria e Infrastrukturës kryen misionin e saj që nga themelimi sipas këtyre ligjeve: Ligji Nr. 2003/11 për rrugët, i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-1201, Ligji Nr. 02/L-70 për sigurinë në trafik, Ligji Nr. 03/L-051 aviacionin civil; Ligji Nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës; Ligji Nr. 04/L-179 për transportin rrugor; dhe Ligji Nr. 04/L-183 për transportimin rrugor të materialeve të rrezikshme.

*Roli dhe misioni i tanishëm.* Misioni kryesor i Ministrisë së Infrastrukturës është krijimi i një mjedisi të sigurt, cilësor dhe funksional për zhvillimin e sistemeve të transportit dhe të burimeve njerëzore për të mundësuar shërbime cilësore dhe të qëndrueshme, mjedis të pastër, rritje ekonomike dhe integrim ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i Ministrisë së Infrastrukturës në sektorin e transportit është: “Kontributi në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e një sistemi të multi-modal efikas, me kosto të ulët dhe të integruar (rrugor, hekurudhor, ajror) që është i sigurt nga pikëpamja mjedisore;

Ligji Nr. 04/L0179 për transportin rrugor, neni 36 theksin: Ministria në kushte të jashtëzakonshme lëshon direktiva për transportimin e detyruar të pasagjerëve në itinerar dhe periudha të caktuara. Në fushën e transportit hekurudhor, MI zhvillon ligje dhe rregullore, harton politika dhe ofron udhëzime strategjike duke marrë parasysh strategjitë e BE-së.

Në fushën e transportit ajror, MI është përgjegjëse për zhvillimin e politikave kombëtare për transportin ajror, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve të ndërlidhura me disa aspekte të ekonomisë së transportit ajror dhe organizimin, realizimin dhe marrjen e masave për zhvillimin e aviacionit civil në Kosovë dhe bashkëpunimit rajonal në fushën e aviacionit civil. Sipas ligjit për aviacionin civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) kanë



kompetencë për të përcaktuar përdorimin e hapësirës ajror për fluturimet civile nga aeroplanë të huaj i cili mund të aplikohet në raste të emergjencave. Reagimi ndaj emergjencave në aviacion brenda një rrezeje prej 8 km nga aeroporti është e koordinuar nga operatori i aeroportit sipas një plani të miratuar nga AAC. Reagimi jashtë kësaj rrezeje koordinohet nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Siguria e Aviacionit Civil mbikëqyret nga ana e MPB-së. Që nga viti 1999, hapësira e sipërme ajrore e Republikës së Kosovës ka qenë e mbyllur dhe pritet të rihapet në prill të vitit 2014.

Roli dhe misioni në të ardhmen. Roli dhe misioni i Ministrisë së Infrastrukturës do të mbetet i pandryshuar në periudhën e ardhshme gjatë periudhës 2014-2018. MI në të ardhmen do të kryej detyrat në pajtim me funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjin në fuqi. Në planet e veprimit të dokumenteve strategjik që MI i ka hartuar, janë definuar projektet dhe grupet e interesit që ndërlidhen me këto projekte.

Analiza. MI ka ngritur kapacitetet ligjore dhe njerëzore dhe është e gatshme të veproj në pajtim me përgjegjësitë që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi. Sipas legjislacionit kompetencat e MI-së përfshijnë rregullimin e fushës së transportit, përkatësisht krijimin e politikave të ndërlidhura me këtë fushë si baze ligjore.

Bazuar në vendimin e NATO-së, hapësira e sipërme ajrore e Kosovës do të hapet në prill 2014,. Kjo hapësirë do të menaxhohet nga HungaroControl Ptc.Ltd sipas marrëveshjes ndërmjet NATO-së dhe autoriteteve hungareze. HungaroControl Ptc.Ltd do të menaxhoj hapësirën e sipërme ajrorë përgjatë 5 viteve të ardhshme. Pas këtyre pesë viteve, planifikohet që Republika e Kosovës do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e hapësirës së saj ajrore.

Pas rihapjes së hapësirës së sipërme ajrore për fluturime, HungaroControl do të jetë përgjegjëse për lejimin e fluturimeve mbi nivelin fluturues 205 (6,205 m), ndërsa Shërbimet e Navigacionit Ajror të Aeroportit ‘Adem Jashari do të ofrojnë shërbime për hapësirën ajrore nën këtë nivel..

Rihapja e hapësirës ajrore të Kosovës duhet të shikohet nga dy perspektiva: trafiku i fluturimeve dhe arritjet/nisjet për/nga Prishtina. Në aspektin e përfitimeve, pritet që 28 fluturime do të përfitojnë në baza ditore nga hapja e hapësirës ajrore.

Sa i përket shërbimeve të navigacionit ajror, gjatë gjysmës së dytë të periudhës së zbatimit të marrëveshjes për dhënien e shërbimeve në hapësirën e sipërme të Kosovës ndërmjet HungaroControl dhe KFOR-it, Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ANSP) planifikon të

shfrytëzoj hapësirat e HungaroControl në Budapest për të ofruar trajnime për kontrollor Kosovar për shërbime transit (en rout). Kjo mund të vazhdohet me trajnime gjatë detyrës në Budapest dhe eventualisht të bëhet licencimi i tyre si kontrollor të zonës nga ana e Autoritetet Hungarez të Aviacionit dhe Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës. Kostoja e trajnimit duhet të mbulohet nga të ardhurat prej ofruesit të shërbimeve në pjesën e sipërme të hapësirës ajrore të Kosovës. Varësisht nga marrëveshja ndërmjet dy palëve, kontrollorët mund të marrin përsipër ofrimin e shërbimeve të hapësirës së sipërme ajrore të Kosovës, fillimisht nga Qendra e zonës së Kontrollit në Budapest dhe më vonë nga Qendra ATC në Prishtinë, për dhe në emër të HungaroControl, nën mbikëqyrjen e HungaroControl.

Kthimi i kontrollit të hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës pas periudhës pesëvjeçare, do të sigurojë qarkullim të konsiderueshëm të parave për ANSP-në. Parashikohet se deri në vitin 2019, përafërsisht 1000 aeroplan në ditë do të qarkullojnë mbi hapësirën ajrore të Kosovës. Me një tarifë prej 50 Euro për aeroplanin fluturues, ANSP do të gjeneroj të ardhura vjetore prej më shumë se 18.000.000.00 Euro.

#### Rekomandimet për MI

- Në bashkëpunim me KFOR dhe HungaroControl, të përgatitet për supozimet eventuale të përgjegjësive sa i përket menaxhimit të hapësirës së sipërme ajrore. (Kostoja e trajnimit të mbulohet nga të ardhurat e gjeneruara nga ofruesi i shërbimeve në hapësirën ajrore të Kosovës).

## **Kapitulli 8 – Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore të RSS-së**

Pas prezantimit të konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komitetit Drejtues dhe me miratimin nga ana e Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe pastaj të Qeverisë së Kosovës, ministritë janë të autorizuar të fillojnë zbatimin e rekomandimeve të shqyrtuara në Kapitullin 7 të këtij dokumenti. Rekomandimet në këtë seksion janë të një rëndësie të veçantë dhe kërkojnë një vëmendje të posaçme si rekomandime kryesore që kanë rrjedhur nga RSSS. Me miratimin e këtyre rekomandimeve nga ana e Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe pastaj nga Qeveria e Kosovës, ministria udhëheqëse e përcaktuar ose organizata nga secili rekomandim kryesor ndër marr veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

- Rishikimi Kushtetutës dhe legjislacionit të Republikës së Kosovës
  - Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni përkatës duhet të rishikohen për të reflektuar në Rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare
  - Për të lehtësuar zbatimin e rekomandimeve të përfshira në RSSS, Këshilli i Sigurisë së Kosovës në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, udhëheq procesin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë aktuale dhe harton një Strategji të re Kombëtare të Sigurisë për tu miratuar nga Qeveria dhe dorëzuar në Kuvend për miratim përfundimtar.
  - Ky rishikim dhe prezantim i Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë për miratim duhet të bëhet jo më larg se fundi i shtatorit 2014.
- Plani i Reagimit Kombëtar:
  - Ministria e Punëve të Brendshme drejton aktivitetin ndër-institucional për të rishikuar dhe publikuar Planin e Ri të Reagimit Kombëtar. Duke marr parasysh rekomandimet e përfshira në RSSS, ky rishikim duhet të ekzaminoj, duke mos u kufizuar, në fushat në vijim si pjesë e një plani të gjerë të qeverisë për të përmirësuar kapacitetet reaguese të Kosovës: standardizimin e pajisjeve në ministritë përkatëse; qendrat e operimit (p.sh. a ka shumë ose pak, a duhet të riaranzhohen kompetencat, etj.); ushtrimet (p.sh. sasia, llojet – të përbashkëta,

fushore kundrejt të brendshme --, kalendari, etj.); dhe marrëdhëniet komandë kontroll.

- Rishikimi dhe publikimi i Planit të Reagimit Kombëtar duhet të bëhet jo më vonë se viti 2015.
- Strategjia e Mbrojtjes Kombëtare:
  - Ministria e mbrojtjes harton dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe e prezanton para Këshillit të Sigurisë së Kosovës për shqyrtim para miratimit nga Qeveria e Kosovës. Dokumenti do të përshkruaj se si Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës do të mbështesin zbatimin e interesave kombëtare dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes do të përshkruaj mjedisin e ardhshëm të sigurisë si ndikon në planifikimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës. Do të përshkruaj strukturën e Forcave të Armatosura të Kosovës, planet për modernizim, nevojat për infrastrukturë, kërkesat për buxhetin e projektuar dhe elemente të tjera që janë të ndërlidhura për të kuptuar dhe përkrahur krijimin e një programi afatgjatë të mbrojtjes. Për më tepër, duhet të qartësohet struktura organizative e Ministrisë, mënyrën se si vepron për zbatimin e mbikëqyrjes së Ministrisë, menaxhimin, administrimin dhe drejtimin e politikave për forcën e ardhshme ushtarake.
  - Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes duhet të prodhohet jo më vonë se dhjetori i vitit 2014.
- Plani për zbatimin e RSSS
  - Zyra e Kryeministrit është përgjegjëse për menaxhimin, koordinimin dhe monitorimin e hartimit të një Plani ndërinstitucional për zbatimin e RSSS-së, të bazuar në planet përkatëse për zbatim të ministrive. Plani themelor i zbatimit të RSSS-së në minimum do të identifikoj secilin veprim/rekomandim që është identifikuar në RSSS; cila Ministri dhe cila zyre në atë Ministri ka përgjegjësi parësore për secilin veprim/rekomandim të përcaktuar; cilat departamente dhe agjenci tjera, nëse ka ndonjë, duhet të kenë rol në zbatim; afati kohor kur do të përmbushet/realizohet veprimi.

- Zyra e Kryeministrit duhet të formoj një grup punues ndër-institucional me nën-grupe përkatëse për të ndihmuar në menaxhimin e Planit për Zbatimin e RSSS-së.
- Grupi punues ndër-institucional në bashkëpunim të ngushtë me ZKM-në koordinon hartimin e planeve të veprimit të Ministrive përkatëse për zbatimin e rekomandimeve të RSSS-së.
- Plani për Zbatimin e RSSS-së duhet të hartohet dhe publikohet jo më vonë se tre mujori i dytë i vitit 2014 dhe të rishikohet sipas nevojës.
- Komisionet e Kuvendit:
  - Zyra e Kryeministrit angazhohet me Kuvendin për të rishikuar përgjegjësitë aktuale mbikëqyrëse të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të krijoj dy komisione të reja mbikëqyrëse: njëri me fokus në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe tjetri në Ministrinë e re të Mbrojtjes.
  - Zyra e Kryeministrit do ta inicioj këtë rekomandim jo më vonë se çereku i katërt i vitit 2014.
- Grupi Punues për NATO
  - Zyra e Kryeministrit themelon një grup punues ndër-institucional për qëllime të zhvillimit të rekomandimeve, ideve dhe veprimeve që Qeveria e Kosovës mund të inicioj për të përmirësuar marrëdhëniet e saj me NATO dhe të vë Kosovën në rrugën drejt pjesëmarrjes në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-së, me synim final të anëtarësimit në NATO. Ky grup punues duhet të drejtohet nga Ministri i Mbrojtjes në përbërje nga përfaqësues të lartë nga secila Ministri pjesëmarrëse në RSSS. Sipas nevojës mund të krijohen edhe nën-grupe punuese të këtij grupi.
  - Grupi Punues për Anëtarësim në NATO duhet të themelohet jo më vonë se çereku i tretë i vitit 2014.
- Programi Kombëtar i Sigurisë dhe Mbrojtjes
  - Duke u bazuar në rekomandimin e Ministrisë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe pëlqimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në këtë RSSS, Universiteti i Prishtinës do të themeloj një kurikull të mbrojtjes dhe sigurisë për

edukimin dhe trajnimin e studentëve universitar në mënyrë që të ndihmoj në procesin e zhvillimit të udhëheqësve të ardhshëm për ministrinë dhe forcën e ardhshme ushtarake.

- Kurikula duhet të zhvillohet dhe të jetë e gatshme për zbatim jo më vonë se viti 2016.

## **Aneksi A - Shkurtesat**

AKRPNS	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Nukleare
ANSP	Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror
AAC	Autoritetit i Aviacionit Civil
AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
SHME	Shërbimet Mjekësore Emergjente
BERZH	
	Banka Evropian për rindërtim dhe Zhvillim
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
GKNM	Grupi Koordinues Ndërministror
PCN	Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Kosovë
GDN	Grupi Drejtues Ndërkombëtar për Kosovën
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave – tash Ministria e Financave
MASHT	
	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MD	Ministria e Drejtësisë
PfP	Partneritetit për Paqe

RBR	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
ATK	Administrata tatimore e Kosovës
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë